



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2 regjistër (JR)
Datë 09.01.2024

Nr. 34 i vendimit
Datë 29.04.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë, në dhomë këshillimi, më datë 29.04.2025, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me sekretar gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Mustafa Turku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 708, datë 26.10.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 dhe neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, dhe Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 708, datë 26.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Mustafa Turku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në bazë të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
 - 2.1 Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
 - 2.2 AKSIK-u ka dërguar në Komision raportin² lidhur me kontrollin për figurën e subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.
 - 2.3 KLP-ja ka dërguar në Komision raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar³ lidhur me aftësitë profesionale, organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në gjetjet nga 5 dosjet e përzgjedhura me short, dokumentacionit të paraqitur prej vetë subjektit, si dhe të dhënat nga burimet arkivore.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, në përfundim të hetimit për të tria kriteret e vlerësimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 708, datë 26.10.2023, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, përfundimet e Komisionit janë si vijon:

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mustafa Turku, me nr. {***} prot., datë 18.04.2019.

² Raporti i AKSIK-ut me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i deklasifikuar plotësisht.

³ Raporti i KLP-së me nr. {***} prot., datë 22.06.2023.

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku, trupi gjykues evidentoi problematika lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit, nga ku rezultoi se është kryer deklarim i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 61, pika 3 dhe nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- Trupi gjykues vlerëson se, gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar dhe verifikimit të deklarimeve të subjektit në raport edhe me dokumentacionin e disponuar të kohës, deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë qenë të bazuara dhe në përputhje me dokumentacionin ligjor provues, përmes të cilit ai dhe personat e lidhur me të kanë fituar të drejta reale mbi pasuritë objekt i këtij hetimi administrativ. Ndër të tjera, bazuar në parimin e objektivitetit e proporcionalitetit, trupi gjykues ka vlerësuar se situata negative financiare, në vlerësimin tërësor të të gjitha pasurive të krijuara dhe shpenzimeve gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës, në shumën (-) 4.397.122 (katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë është e tillë që të detyron aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

- Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-ut dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

- Në vlerësim të përgjithshëm të çështjeve të trajtuara lidhur me denoncimet, referuar edhe konkluzionit për pikën 28.5⁴ dhe 28.5.11⁵, të cilat evidentuan ekzistencën e një vlerësimi me mangësi të çështjes, trupi gjykues çmon se veprimet e subjektit, të paktën në dy raste, krijojnë kushte për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

- Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Mustafa Turku gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), kundër vendimit të përmbledhur më sipër⁶, me bazë ligjore si në hyrje të këtij vendimi, i cili përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave të

⁴ Lidhur me procedimin penal nr. {***}, me kallëzues shtetasin A. B., të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, për të cilin subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal në bazë të nenit 328, pika 1, shkronja “a” e K. Pr. Penale.

⁵ Lidhur me çështjen e ekzekutimit të vendimit për të dënuarin V. Y.

⁶ Në lajmërimin e marrjes për njoftimin e vendimit të Komisionit nr. 708, datë 26.10.2023, të arsyetuar, krahas nënshkrimit të marrësit, pasqyrohet data 04.12.2023. Për pasojë, ankimi i administruar në Komision, në datën 18.12.2023, rezultoi i paraqitur brenda afatit ligjor 15-ditor.

administruara prej Komisionit. Bashkë me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka sjellë një akt shkresor, në cilësinë e provës së re, dhe kërkon nga Kolegji shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjithë dokumentacionit të administruar, shqyrtimin në themel të fakteve e provave dhe vlerësimin objektiv të të tria kritereve të rivlerësimit. Përmes ankimit, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 59 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kërkuar që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 708, datë 26.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
- *Konfirmimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të subjektit të rivlerësimit, z. Mustafa Turku, në vlerësim të të tria kritereve të vlerësimit.*

5. Subjekti ka pretenduar se vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të së drejtës për proces të rregullt, sikurse edhe në vlerësim të gabuar të kriterit të kontrollit të pasurisë.

5.1. Për sa i përket argumenteve për cenim të procesit të rregullt dhe të aspekteve procedurale të procesit të rivlerësimit të tij, subjekti i rivlerësimit potencon se: (i) Në procedurën e ndjekur dhe vendimin e Komisionit ka elemente të theksuara të paragjykitimit dhe të një vendimi të paracaktuar, që prej tij bëjnë të pretendohet për shkelje të parimit të gjykitimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe ekzistencë të një vendimi të paragjykuar dhe paracaktuar. (ii) Konkluzioni që dy raste krijojnë kushte për *cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*, është një standard joligjor, nuk bazohet në prova dhe në ligj, duke bërë që Komisioni të dalë jashtë diskrecionit që ligji i ka dhënë për përmbushjen e funksioneve. (iii) Për kriterin e pasurisë, vendimi është marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b”, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.2. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, argumentet e subjektit, në mënyrë të përmbledhur, janë si më poshtë:

5.2.1. Lidhur me pasurinë “Apartament 3+1+shtesa”, me sipërfaqe 84.40 m², ndodhur në pallatin {***}, shkalla {***}, ap. {***}, Elbasan, nuk ka pasur shitje të apartamentit, por ndërrim banese, shpenzimi ka qenë 300.000 lekë, në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e motrës nga puna, dhe përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve të prindërve është joproporcionale në raport me periudhën e punësimit, të ardhurat dhe mundësitë për kursim. Lidhur me shtesën e ndërtuar në vitin 2000, vlera e shpenzimeve prej 300.000 lekësh është paguar në vitin 2019, provuar me deklaram të ndërtuesit I. L., dhe deklaramet e tij në deklaratat periodike të pasurisë.

5.2.2. Lidhur me pasurinë “Apartament banimi” (garsoniere), me sipërfaqe 33,84 m², në {***}, Kavajë, në emër të bashkëshortes, përfituar sipas kontratës së shitblerjes datë 18.11.2005, në mënyrë të padrejtë është përlllogaritur si shpenzim vlera e ndërtimit prej 846.400 lekë sipas kostove të ndërtimit të EKB-së.

5.2.3. Lidhur me pasurinë “Automjet”, tip “Mercedes Benz”, me targë {***}, me vlerë 700.000 lekë, ky automjet është blerë nga babai i tij me të ardhura të siguruara nga ai vetë dhe shuma është dhënë me këste, siç ka deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe në deklaratën *vetting*.

5.2.4. Në lidhje me pasurinë “Automjet”, tip “Opel Corsa 1.2”, me targë {***}, vlera e blerjes prej 700.000 lekë, në vitin 2009, përbëhet nga shuma 400.000 lekë, çmimi i shitjes së automjetit “Renault”, deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2008, e cila ka qenë gjendje *cash* në shtëpi, duke i shtuar shumën 300.000 lekë kurtime nga paga, si dhe të ardhura të tjera të familjes. Në analizën financiare nuk janë përfshirë veç të ardhurave të subjektit dhe të bashkëshortes, edhe ato të nënës së subjektit.

5.2.5. Lidhur me depozitat bankare, deri në datën 31.12.2003, në vlerën 3.100.000 lekë, ky likuiditet është krijuar nga viti 1982 e në vijim, referuar historikut të dokumenteve bankare të vëna në dispozicion, prandaj është e padrejtë të përllogaritet sikur likuiditeti është krijuar prej tij në vitin 2003.

5.2.6. Lidhur me burimin e gjendjes së kursimeve *cash* në vitin 2005 dhe 2007, për të cilat Komisioni konkludon se ka pasur pamundësi financiare për krijimin e tyre, në kohën kur është pyetur nga inspektorët e ILDKPKI-së, nuk është konstatuar ndonjë balancë negative apo dyshim mbi burimin e aseteve për vitet 2005 – 2007, por janë kërkuar sqarime mbi shënimet që pasqyrojnë paqartësi në deklaratën e pasurisë, për pasojë deduksioni i Komisionit nuk qëndron. Gjithashtu, nuk janë përllogaritur të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja nga puna në shkollën “{***}” dhe në “{***}”.

Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional

5.3. Për sa i përket kriterit të vlerësimit profesional, argumentet e subjektit, në mënyrë të përmblodhur, janë si më poshtë:

5.3.1. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, viti 2011⁷, i regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me kallëzues shtetasin A. B., vendimi i pushimit të këtij procedimi penal është bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Penale, me argumentin se fakti nuk ekziston, pasi nuk kishte falsifikim. Vendimmarrja nuk është bazuar në kopjet e pavërtetuara të shkresave, ato janë marrë me qëllim orientimin e hetimit.

5.3.2. Lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor për shtetasin V. Y., të ndjekur prej tij në cilësinë e prokurorit, konkluzioni i Komisionit për cenim të besimit të publikut të drejtësia, është i padrejtë jo vetëm për shkak të mosrespektimit të normave procedurale që garantojnë procesin e rregullt, por edhe për vetë thelbin e tij. Në qëndrimet e tij nuk ka asgjë konfuze, ka përfaqësuar organin e akuzës në mënyrë dinjitoze dhe ka mbrojtur interesin publik në mënyrën më të mirë të mundshme dhe në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale (në vijim “K. Pr. Penale”).

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit. Për rrjedhojë, çështja me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili

⁷ Shih “Të dhëna nga burime arkivore”, f. 24 e vendimit të Komisionit, pika 28 dhe nënpikat e saj.

merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. *Legjitimimi i ankuesit*

7. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

8. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues vlerëson se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Trupi gjykues i Kolegjit e shqyrtoi këtë çështje në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi vlerësoi se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike.

8.1. Subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit paraqiti dhe kërkoi të merret në cilësinë e provës për konstatimin e drejtë të gjendjes faktike, akt-ekspertimin e ekspertës I. D.,⁸ për kryerjen e vlerësimit të pasurisë së subjektit, për periudhën 1990 – 2016. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka pranuar kërkesën e tij për kryerjen e një analize financiare nga ekspertë të fushës bankare dhe, pas dhënies së vendimit, i është drejtuar ekspertit të fushës. Nën dritën e parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, të cilat diktojnë kushtet kur mund të paraqiten prova të reja në ankim, trupi gjykues vendosi të mos e pranonte këtë akt.

8.2. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kërkesës së subjektit për kryerje të analizës financiare me ekspertë bankarë, i është dhënë përgjigje nga Komisioni me dy vendimeve të ndërmjetme, konkretisht: (i) Me vendimin nr. {***}, datë 18.10.2023, me të cilin është vendosur: “2. Mospranimin e kërkesës për kryerje të analizës financiare nga ekspertë të fushës bankare, pasi analiza është përgatitur nga NjShL-ja pranë KPK-së, sipas parashikimeve të nenit 22 dhe nenit 23 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti mund të paraqesë dokumentacion apo analizë të kryer sipas vlerësimit të tij. 3. Në lidhje me kërkesën për paraqitje në vijimësi të dokumenteve të tjera provuese që mund të administrohen prej tij, subjekti i rivlerësimit mund t’i paraqesë ato deri në seancën dëgjimore, datë 24 tetor 2023, ora 10:00”. (ii) Me vendimin nr. {***}, datë 24.10.2023,⁹ ku në pikën e parë

⁸ Sipas përshkrimit në hyrje të akt-ekspertimit, znj. I. D., paraqitet si audituese ligjore me licencë nr. {***}, datë 08.11.2011, e shoqërisë {***} ShPK, regjistruar me NIPT {***}, rruga “{***}”, pallati “{***}”, kati {***}. Bashkëlidhur akt-ekspertimit nuk është depozituar kopje e licencës. Nga burime të hapura: <https://pas-ut.com/ekipi-yne/>, rezulton se znj. D., audituese ligjore, është anëtare e Bordit të Drejtorëve të IEKA-s nga qershori i vitit 2022.

⁹ Subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore ka paraqitur kërkesë për ribërje të analizës financiare me ekspert bankar, për sa kohë nuk i është dhënë përgjigje për lëvizjen e depozitave nga viti 1998. Shih procesverbalin e seancës dëgjimore, fashikulli 17, faqe 15. Kërkesa për marrje të një eksperti bankar është refuzuar prej Komisionit me arsyetimin se sipas ligjit, nëpërmjet NjShL-së, Komisioni ka kryer analizën financiare, ndërkohë subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të kundërshtuar konstatimet e Komisionit dhe për të paraqitur një analizë të re financiare dhe akt-ekspertimin financiar.

Komisioni shprehet për pranimin e kërkesës së subjektit për administrimin e dokumenteve të paraqitura apo të atyre që mund të paraqesë deri në fund të seancës, dhe në pikën e dytë: *“Mospranimin e kërkesës për kryerje të analizës financiare nga ekspertë të fushës bankare, pasi analiza është përgatitur nga NjShL-ja pranë KPK-së, sipas parashikimeve të nenit 22 dhe nenit 23 të ligjit nr. 84/2016”*. Duke nënvizuar detyrimin e subjekteve për të paraqitur provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, në zbatim të barrës së provës, e cila, sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i takon subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e vlerëson ripërsëritjen e kërkesës për kryerje të analizës financiare nga ekspertë të fushës bankare përpos të pabazuar, edhe të pakuptimtë, për sa subjekti prezumohet i njohur me parashikimet e ligjit lidhur me procedurat e kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, të zbatuara me rigorozitet nga organet e rivlerësimit, si edhe me barrën e provës që i kalon subjektit vetëm në këtë proces lidhur me provueshmërinë e fakteve të pretenduara. Në rrethanat ligjore dhe faktike të sipërpërkshkruara, që dëshmojnë se mosparaqitja në Komision e analizës financiare sipas pretendimeve të tij ka qenë zgjedhje e vetë subjektit, nuk mund të kërkohej marrja si provë e këtij akti në Kolegj.

8.3. *Së dyti*, sikundër do të analizohet gjerësisht në vijim, kundërshtimet e subjektit lidhur me analizën financiare të Komisionit konsistojnë në mospërfshirje të të ardhurave të pretenduara apo për mundësi financiare për krijimin e depozitave bankare, pretendime të cilat subjekti ka dështuar t’i provojë me dokumentacion justifikues në kuptim të ligjit. Për rrjedhojë, edhe në këtë këndvështrim, akt-ekspertimi financiar, i cili mbështetet në deklaratimet e subjektit, përpos moskalimit të testit formal për pranimin e tij, edhe në drejtim të vlerës së tij provuese, nuk përmbush testin e nenit 49, pika c, të ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht këtij arsytimi, trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit në ankim të mbështetura në konkluzionet e aktit të ekspertimit në kuadër të shqyrtimit të ankimit dhe duke i konsideruar ato si pjesë integrale e tij.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

9. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të adresuara ndaj shkeljeve, që sipas tij kanë cenuar procesin e rregullt ligjor, të cilat u analizuan si më poshtë:
10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në procedurën e ndjekur dhe vendimin e Komisionit ka elemente të theksuara të paragjyqimit dhe të një vendimi të paracaktuar, që bëjnë që prej tij të vihet seriozisht në dyshim fakti nëse është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, dhe për ekzistencën e një vendimi të paragjykuar dhe të paracaktuar.

10.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit që *dy raste krijojnë kushte për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*, është një standard joligjor, pasi nuk bazohet në prova dhe në ligj, dhe bën që Komisioni të dalë jashtë diskrecionit që ligji i ka dhënë për përmbushjen e funksioneve. Sipas tij, vlerësimi i paplotë mbi kontrollin e aftësive profesionale, vlerësim i kryer jo në përputhje me nenin 44 të ligjit nr. 84/2016¹⁰, cenon të drejtat për një proces të drejtë ligjor. Raporti

¹⁰ Neni 44 i ligjit nr. 84/2016, i titulluar “Relacioni i rivlerësimit”, parashikon: [...] Relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve e tjera ligjore. Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë:

a) “I aftë”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme; b) “Me mangësi”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave,

i inspektorëve, kriteret e parashikuara nga kuadri ligjor dhe nënligjor që rregullojnë veprimtarinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk dëshmonin për paaftësi profesionale dhe se nuk ka informacione të siguruar nga burime të tjera, pasi nuk ka pasur burime të tjera informacioni, pjesë e dosjes administrative, potenco i subjekti.

10.1.1. Trupi gjykues, duke sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese se *në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse,*¹¹ e vlerëson këtë pretendim të pabazuar për sa vijon. Nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, rezulton se lidhur me procedimin penal nr. {***}, me kallëzues shtetasin A. B., marrë shkas nga verifikimi i të dhënave arkivore pranë institucioneve përkatëse, nga ku ka rezultuar se ky shtetas ka depozituar, në kohë, ndaj subjektit të rivlerësimit disa kallëzime penale, si edhe disa ankesa në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni ka kryer një hetim të plotë. Pas analizimit të dokumentacionit të administruar,¹² Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove se nga veprimet hetimore të ndjekura prej tij konstatohen mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, në kuptim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, dhe nenit 40 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, për indicet nga burime të hapura¹³, prej nga ka rezultuar se shtetasi V. Y., i cili po vuante dënimin për dy vrasje, nëpërmjet kërkesave drejtuar gjykatës, ka kërkuar lirim nga burgu i Peqinit duke i njohur ditët e punës në burg, ku po vuante dënimin, dhe prokurori i çështjes Mustafa Turku ka shprehur dakordësinë në shkallën e parë gjykim, duke apeluar vendimin e gjykatës në vijim, për verifikimin e të dhënave, Komisioni ka kërkuar dhe administruar dokumentacionin përkatës nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si dhe Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Nga vlerësimi i akteve në tërësinë e tyre, pa gjykuar themelin e çështjes apo qëndrime lidhur me këtë proces, por vetëm veprimet dhe sjelljet e organit të akuzës, të përfaqësuar nga subjekti rivlerësimit, Komisioni ka çmuar se sjelljet e subjektit të rivlerësimit në këtë proces duken të tilla që duhet të merren në konsideratë dhe të vlerësohen në drejtim të nënindikatorëve të përcaktuar nga ligjit nr. 96/2016, si dhe në raport me nenin 471 të K. Pr. Penale. Duke vlerësuar se qëndrimet e prokurorit duket se nuk janë koherente dhe nga vlerësimi në tërësi i situatës duket se ka pasur një seri vendimesh lidhur me uljet e kohës së vuajtjes së dënimit për kërkuesin, për të cilat subjekti/prokurori Mustafa Turku, hera-herës, nuk ka vlerësuar të marrë pjesë dhe as ankimuar, dhe qëndrimi i tij lidhur me ankimin ndaj vendimit nr. {***}, datë 27.11.2019, duket i paqartë, konfuz dhe në mungesë të plotë koherence, Komisioni ka kërkuar prej subjektit dhënien e shpjegimeve dhe paraqitjen e dokumentacionit provues lidhur me pretendimet. Në vendim, lidhur me këto dy çështje, Komisioni ka pasqyruar shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit, analizën për to, duke konkluduar se veprimet e subjektit krijojnë kushte për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se Komisioni ka dalë përtej diskrecionit për përmbushjen e funksioneve, vlerësohet i pabazuar. Gjithashtu, sikundër

nuk është efektiv. Komisioni ka rekomanduar program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës, për të plotësuar këto mangësi brenda një viti; c) "I papërshtatshëm", kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës. [...]

¹¹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017.

¹² Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.10.2020, të Prokurorisë së Përgjithshme, dhe me nr. {***} prot., datë 03.08.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

¹³ <https://www.cna.al/2021/02/13/u-pendua-per-lirimin-e-dajes-se-padrinos-prokurori-ne-listen-e-zeze-te-pasurive-2>.

do të analizohet gjerësisht në vijim, edhe pretendimi se konkluzioni i Komisionit në këto dy çështje është i pabazuar në prova dhe në ligj, vlerësohet i pabazuar.

10.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se mosmarrja në konsideratë e asnjë argumenti dhe prove të paraqitur prej tij në kuadër të barrës së provës dhe shpjegimeve të kërkuara, evidentimi i gjetjeve nga Komisioni, që në mënyrë të dukshme prej tij iu dhanë sqarime në kuadër të barrës së provës, vlerësimi ndryshe nga sa provonte edhe dokumentacioni i dosjeve penale nr. {***} dhe nr. {***} dhe aktet ligjore në fuqi, mosarsyetimi në vendim lidhur me pretendimet e tij, *se çdo burim i të ardhurave është provuar dhe ka origjinë të ligjshme, dhe se detyra e prokurorit është kontrolluar nëpërmjet vendimeve gjyqësore*, bëjnë që prej tij të vihet seriozisht në dyshim dhe të pretendohet për shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, dhe të ekzistencës së një vendimi të paragjykuar dhe të paracaktuar. Neni Ç, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës garanton të drejtën për një proces të rregullt, që nënkupton se çdokush që është palë në proces, duhet të ketë mundësi të paraqesë çështjen e vet, dhe *asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit*, potencoi subjekti.

10.2.1. Trupi gjykues, nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi dhe akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton se në vendim janë pasqyruar shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit, si gjatë hetimit administrativ kryesisht, ashtu edhe ato në përgjigje të barrës së provës, si në rastin e pasurive objekt hetimi, ashtu edhe për çështjet lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, madje duke i transpozuar ato literalisht, në përmbushje të kërkesave të nenit 48 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative¹⁴. Shpjegimet dhe argumentet e subjektit, përfshirë pretendimin *se çdo burim i të ardhurave është provuar dhe ka origjinë të ligjshme*, janë vlerësuar në raport me dokumentacionin e administruar, ku për pretendimet e paprovuara me dokumentacion, apo të mbështetura nga deklaratat noteriale të bëra gjatë procesit të rivlerësimit, përpos pasqyrimin dhe konkludimit si deklarative, analizimi nuk do të kishte relevancë. Lidhur me pretendimin *se detyra e prokurorit është kontrolluar nëpërmjet vendimeve gjyqësore*, trupi gjykues konstaton se në rastin e procedimit penal nr. {***}, vendimi i prokurorit/subjektit është prishur nga gjykata. Ndërsa për çështjen e vuajtjes së dënimit nga shtetasi V. Y., Komisioni, nga analizimi në tërësi i situatës, lidhur me sjelljet pasive të organit të akuzës, përfaqësuar nga subjekti, si dhe në fund ankimin ndaj një vendimi gjykate, për të cilin është shprehur dakord gjatë gjykimit, e që në vetvete mbetet e papërligjshme në ndonjë rrethanë, ka vlerësuar se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk mundin të justifikojnë thelbin e zgjidhjes së çështjes, e cila, e vlerësuar në tërësinë e saj, ka cenuar thelbin e veprimtarisë së organit të akuzës, duke e shndërruar atë në një proces abuziv. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se procesi i rivlerësimit në Komision ka garantuar për subjektin të drejtën për një proces të rregullt dhe, në asnjë këndvështrim, nuk konstatohen shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme apo ekzistencë e një vendimi të paragjykuar dhe paracaktuar.

10.3. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për kriterin e pasurisë, vendimi është marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b”, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Sipas tij, në interpretim të dispozitave të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe e ligjit nr. 84/2016 nuk është që nga ky proces i rivlerësimit kalimtar të

¹⁴ Neni 48 parashikon: “Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij kodi”. Ndërsa, neni 47 parashikon: “Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethanat apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”.

evidentohen pasaktësitë në plotësimin e deklaratave periodike vjetore të pasurisë, për sa kohë pasuritë në pronësi apo në përdorim janë deklaruar saktësisht dhe plotësisht, dhe burimi i ligjshëm i krijimit të tyre provohet bindshëm. Për pasaktësi të kësaj natyre, vetë ligji nr. 9049/2003 nuk parashikon ndëshkim, pasi konstatimi i gabimeve materiale apo i plotësimeve të gabuara duhet të bëhet brenda vitit gjatë përpunimit paraprak të të dhënave.

10.3.1. Duke qenë se një analizë e detajuar e themelit të pretendimeve për konkluzionet e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë shtjellohet më tej në vendim, analiza e trupit gjykues në këtë pikë të arsyetimit kryhet në funksion të pretendimeve të subjektit me natyrë procedurale. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 kanë përcaktuar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si një masë *të jashtëzakonshme* dhe me natyrë kalimtare, qëllimi i të cilit është të qëndrojnë në detyrë magjistratët të cilët rezultojnë të përshtatshëm për të ushtruar funksionin e dhënies së drejtësisë. Neni D i Aneksit të Kushtetutës, materializuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, parashikojnë se objekt i vlerësimit pasuror është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ky ka qenë edhe vlerësimi i elaboruar nga GjEDNJ-ja në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë. Në këtë kontekst, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk është shkarkuar nga detyra për shkak të deklarimeve të kryera në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, por pasi Komisioni ka konstatuar se ai nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas analizës së kryer nën dritën e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016¹⁵. Thënë ndryshe, kontrolli i pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin është objekt i kontrollit të pasurisë gjatë rivlerësimit dhe deklaratat periodike vjetore të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për të kontrolluar saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar. Për pasojë, pretendimi i subjektit, se pasaktësitë në deklaratimet periodike nuk cenojnë apo vënë në diskutim të provuarit bindshëm të burimit të ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe se përdorimi si provë i deklaratave periodike vjetore sipas nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk do të thotë që Komisioni të marrë masën ekstreme disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit për plotësim jo të saktë/të gabuar të tyre, ndonëse konfirmohet në planin teorik, nuk rezulton të jetë i bazuar në rastin konkret, përderisa rezulton se masa disiplinore e marrë nga Komisioni është mbështetur mbi pasaktësinë e deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* e në mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe jo mbi pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike të pasurisë në vite.

10.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk arsyeton përse nuk merret në konsideratë analiza financiare e kryer nga ILDKPKI-ja, për sa hetimi administrativ nuk ka provuar asgjë ndryshe nga sa ka konstatuar ILDKPKI-ja, mënyrë veprimi që krijon dyshim për vendim të paragjykuar dhe të paracaktuar. Sipas subjektit, referuar analizës financiare të ILDKPKI-së dhe shpjegimeve të dhëna prej tij, rezulton se provohet bindshëm burimi i të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin

¹⁵ Pika 1 dhe 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”. [...] “3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj. [...]”.

e pasurive dhe nuk janë kushtet e kriteret e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, sa i përket deklaramit të pamjaftueshëm. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm” bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti sipas deklaratës së pasurisë *vetting* nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë apo kur tenton të kryejë fshehje, apo deklarim të rremë të pasurisë, dhe për të arritur në këtë konkluzion, parashikimi i nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, kërkon përpjekje për të fshehur pasurinë, përpjekje që duhet të justifikohet me qëllimin për të manipuluar procesin e rivlerësimit, potencoi subjekti.

10.4.1. Duke risjellë në vëmendje qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese të cituar në paragrafin 10.1.1., si dhe vlerësimin e Gjykatës, në po të njëjtin vendim, se *organet ekzistuese ligjzbatuese kanë vetëm rol ndihmës në procesin e rivlerësimit, përderisa veprimtaria e tyre ushtrohet nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e organeve kushtetuese të rivlerësimit [KPK-ja dhe KPA-ja]*, trupi gjykues thekson se, në të kundërt nga sa pretenduar prej subjektit, hetimi i thelluar i kryer prej Komisionit ka provuar ekzistencën e fakteve për të cilat ai ka dështuar të përmbysë barrën e provës dhe të provojë pretendimet e tij me dokumentacion, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor të rivlerësimit. Lidhur me pretendimet se për konkluzionin “deklarim i pamjaftueshëm”, parashikimi i nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës kërkon përpjekje për të fshehur pasurinë, përpjekje që duhet të justifikohet me qëllimin për të manipuluar procesin e rivlerësimit, Kolegji ka mbajtur qëndrim në jurisprudencën e tij, duke i vlerësuar ato të pabazuara. Koncepti i deklaramit të pamjaftueshëm i përket konkluzionit se një subjekt rivlerësimi gjendet të paktën në një prej rrethanave të parashikuara prej nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat plotësojnë kushtin ligjor për të konkluduar se plotësohen përcaktimet e nenit 61, pika 3 e ligjit, që pasjellin vendosjen e masës disiplinore. Në konsideratë të këtij qëndrimi të Kolegjit dhe për sa, për disa prej pasurive objekt rivlerësimi, subjekti ka dështuar të provojë burimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e tyre, pretendimet e subjektit lidhur me konkluzionin e Komisionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, se nuk janë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, vlerësohen nga trupi gjykues, të pabazuara. Këtë vlerësim, trupi gjykues ndan edhe për pretendimet e tjera lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, se nga vlerësimi tërësor i rrethanave dhe fakteve, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, Komisioni duhet të arrijë në përfundimin se pasaktësitë në deklarim nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë apo se nuk ka në pronësi, apo në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, dhe se ka deklaruar plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike të pasurisë. Lidhur me deklaramet e pasurive prej subjektit, në vijim të këtij vendimi do të bëhet një analizë shteruese.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

Pasuria “Shtëpi banimi, apartament 3+1+shtesa”, me sipërfaqe 84.40 m², ndodhur në pallatin {}, shkalla {***}, ap. {***}, Elbasan***

11. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me këtë pasuri, subjekti deklaron:

*Shtëpi banimi apartament 3+1+shtesa, me sipërfaqe fillestare 70 m² dhe sipërfaqe shtesë 14.40 m², në total 84.40 m², ndodhur në pallatin {***}, shkalla {***}, ap. {***}, Elbasan. Shtëpia i është blerë shtetasit R. L. Këtij shtetasi i është dhënë banesa ime e mëparshme prej 2+1, e ndodhur po në pallatin {***}. Shtëpitë janë këmbyer mes nesh dhe shtetasit R. L., i është dhënë një shumë prej rreth 300.000 lekësh për një dhomë më shumë.*

*Që të dyja banesat janë përfituar nga privatizimi i tyre në vitin 1993. Vlera e shitblerjes së banesave të përcaktuara në kontratat respektive është vlera e tregut për to në atë kohë (viti 1998) dhe nuk është vlera në lekë e shitblerjes së tyre. Banesa e blerë konfirmohet me kontratën e shitjes nr. {***}, datë 30.10.1998. Banesa e shitur konfirmohet me kontratën e shitjes nr. {***}, datë 30.10.1998. Banesa e blerë është regjistruar me nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, ZK {***}, adresë: lagjja "{***}" dhe është lëshuar certifikata e pronësisë datë 07.12.2005.*

Vlera e shtëpisë sime të shitur është vënë 1.480.000 lekë. Vlera e shtëpisë së blerë nga ana ime është 1.980.000 lekë. Pasuria deklarohet në bashkëpronësi.

*Banesës i është bërë shtesa në vitin 2000, me një sipërfaqe prej 14.40 m². Shtesa është bërë me miratim të Bashkisë Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 22.09.1999, të KRRT-së Bashkia Elbasan. Vlera me preventiv e shtesës është 299.820 lekë, e cila ende nuk i është paguar firmës ndërtuese "{***}". Vlera e shtesës së banesës është 299.820 lekë.*

*Shtesa është legalizuar nga ALUIZNI Elbasan, leje legalizimi nr. {***}, datë 08.12.2015/nr. {***}. Procesi është i përfunduar nga ZVRPP-ja Elbasan. Konfirmuar pasuria nga ZVRPP-ja Elbasan, me shkresën nr. {***}, datë 25.10.2016. Pasuria deklarohet në bashkëpronësi.*

12. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri dhe se ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Pas hetimit administrativ të kryer, Komisioni ka konsideruar 500.000 lekë vlerën e shpenzuar për shtëpinë e këmbyer në vitin 1998, duke iu referuar kontratave të shitblerjes së apartamenteve, duke mos pranuar shpjegimet e subjektit në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, për një vlerë të shpenzuar prej 300.000 lekësh, dhe duke pranuar vetëm pretendimet lidhur me pjesën e tij takuese¹⁶. Vlera për shtesën në vitin 2000 është konsideruar e paguar në atë periudhë, duke vlerësuar pa logjikë të arsyeshme shpjegimet e subjektit, që nuk gjejnë pasqyrim në zbatim të detyrimit ligjor, në deklaratat periodike të pasurisë përkatëse. Në vlerësim të situatës pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e rishikuar, duke përfshirë të ardhurat e prindërve të tij, dhe duke llogaritur shpenzimet për jetesë në familjen me 4 persona në masën 30%, referuar të ardhurave të subjektit dhe të ardhurave të prindërve nga pensionet, si shpenzime në masën 66%, referuar masës së pensionit, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi financiare në vlerën prej (-) 529.053 lekësh për krijimin e pasurisë "Apartament banimi", me sipërfaqe totale 84.40 m².
13. Subjekti kundërshton në tërësi këtë konkluzion të Komisionit, duke potencuar disa aspekte. *Së pari*, në lidhje me apartamentin 3+1, subjekti pretendon se nuk ka pasur shitje të apartamenteve, por ndërrim banese dhe shpenzimi faktik ka qenë në vlerën 300.000 lekë, dhënë shtetasit R. L., fakt i shënuar në deklarimin periodik vjetor, si dhe në deklarimin para ILDKPKI-së në vitin 2011. Sipas subjektit, në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e motrës së tij, për atë periudhë që ka kontribuar, si dhe ka qenë joproporcionale përllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve të prindërve, të cilët kanë pasur mundësi kursimi për shumë vite punë me të ardhura të konsiderueshme. *Së dyti*, në lidhje me ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2000, subjekti pretendon se vlera e ndërtimit prej 300.000 lekësh është përfshirë me të padrejtë në këtë vit, pasi është provuar me deklarimin e I. L., (ndërtuesit) dhe deklarimet periodike të pasurisë, që kjo vlerë nuk është paguar

¹⁶ Në DPV-në e vitit 2003, subjekti e deklaroi këtë pasuri si të përfituar nga privatizimi, zotërues i 1/6 pjesë. Nga dokumentacioni rezulton se pasuria është përfituar me kontratë shitblerjeje datë 30.09.1998 dhe përfitues i vetëm është subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit.

deri në vitin 2016, por është paguar në vitin 2019. Sipas subjektit, pagesa do të bëhej kur të bëhej kontrata, e cila është bërë në vitin 2019, provuar kjo edhe nga tapia mbi pronësinë e shtesës, fatura tatimore e datës 30.12.2019, së bashku me situacionin e punimeve datë 26.12.2019. *Së treti*, subjekti pretendon se prej Komisionit janë mbajtur dy standarde, për ndërrimin e apartamenteve janë konsideruar vetëm kontratat, ndërsa për pagesën e shtesës nuk është marrë në konsideratë dokumentacioni provues. *Së katërti*, subjekti pretendon vlerësimin në nivel të lartë të shpenzimeve jetike për familjen e tij, duke iu referuar një vlerësimi mesatar, pa mbajtur në konsideratë që të gjithë pjesëtarët kanë qenë një familje e vetme e pandarë, jetonin në të njëjtën banesë prej shumë vitesh (gjyshja, babai, nëna, subjekti, bashkëshortja dhe motra), të gjithë kishin kontributet e tyre me të ardhura nga pagat dhe pensionet, dhe nuk është marrë në konsideratë se në qytetin e Elbasanit niveli i jetesës së një familjeje nuk është si në kryeqytet.

14. Pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikull dhe analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë se për këmbimin e banesave/apartamenteve nuk është dhënë shuma 500.000 lekë, sa rezulton diferenca e çmimeve në kontratat respektive të shitblerjes së tyre të datës 30.10.1998. Po ashtu, subjekti nuk arriti të provojë që vlerën prej 299.820 lekësh të punimeve të ndërtimit të shtesës së apartamentit, me sipërfaqe prej 14.39 m², nuk e ka shlyer në vitin 2000, kur punimet kanë përfunduar sipas deklarimit të tij. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues për këtë pasuri mbështetet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.

14.1. Së pari, nga aktet në fashikull rezulton e dokumentuar sa vijon:

- (i) Në datën 30.10.1998, sipas kontratave noteriale të shitjes me nr. {***} rep., nr.{***} kol., shtetasit B., F., A., S., dhe Mustafa Turku (i ati, e ëma, e motra, bashkëshortja dhe vetë subjekti), GJ., T., (B.) dhe F. T., (trashëgimtarë ligjorë të gjyshes së subjektit, E. T.), të përfaqësuar me prokurë nga subjekti i rivlerësimit, i shesin shtetasit R. L., pasurinë “Apartament 2+1”, të ndodhur në lagjen “{***}”, pallati {***}, shk. {***}, ap. {***}¹⁷, në shumën 1.480.000 lekë; dhe me nr. {***} rep., nr.{***} kol., shtetasit R., V., dhe R. L., i shesin subjektit të rivlerësimit pasurinë “Apartament 3+1”, të ndodhur në lagjen “{***}”, pallati {***}, shk. {***}, ap. {***}, në shumën 1.980.000 lekë.
- (ii) Në datën 06.09.2001, pasuria “Apartament”, me sipërfaqe totale 82 m² është regjistruar në pronësi vetëm të subjektit të rivlerësimit, i cili është pajisur me certifikatë pronësie në datën 07.12.2005¹⁸.
- (iii) Në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2003 (në vijim “DPV” për deklaratat periodike të pasurisë), subjekti deklaron: shtëpi banimi 70 m², me adresën përkatëse, burim krijimi përfituar nga privatizimi, vlera 4 milionë lekë, pjesa që zotëron 1/6.
- (iv) Në datën 03.12.2015 është pajisur me leje legalizimi objekti “shtesë” me sipërfaqe 13.9 m² dhe, sipas certifikatës së pronësisë datë 23.10.2018, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.¹⁹ Në DPV-në 2015, subjekti deklaron legalizimin e shtesës së banesës prej 13.9 m² me të dhënat

¹⁷ Referuar kontratës nr. {***}, datë 03.10.1994, lidhur mes {***} dhe B. T., shtetasit B., F., E., A., Mustafa dhe S. T., kanë përfituar pasurinë “Apartament 2+1”. Referuar vendimit nr. {***}, datë 28.12.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është çelur dëshmia e trashëgimisë për trashëgimlënësen E. T., ku trashëgimtarë ligjorë rezultojnë B. T., GJ. T., (B.) dhe F. T.

¹⁸ Pasuria është regjistruar me nr. {***}, ZK {***}, volum {***}, f. {***}, me adresë: Lagjja “{***}”, pallati {***}, shk. {***}, k. {***}, ap. {***}.

¹⁹ Pasuria “Apartament” me sipërfaqe 13.9 m² është regjistruar me nr. {***}, ZK {***}, volum {***}, f. {***}, me adresë: Lagjja “{***}”, shk. {***}, k. {***}, ap. {***}.

përkatëse të lejes së legalizimit, vlerë të legalizimit 3.024 lekë dhe 10.000 lekë në bono privatizimi. Vlera me preventiv e këtij ndërtimi është 299.820 lekë, sipas dokumentit preventiv të vitit 2019, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK, është deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting nga subjekti i rivlerësimit, si e pashlyer.

14.2. Nga analiza e akteve të mësipërme, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje disa konstatime. Së pari, deklarimi i kësaj pasurie në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, si të përfituar nga privatizimi, zotërues i 1/6 pjesë, ndërsa nga dokumentacioni rezulton se është përfituar me kontratë shitblerjeje, datë 30.09.1998, me përfitues të vetëm subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, nuk provon pretendimin e subjektit, se në deklarin periodik vjetor është shënuar që për ndërrimin e banesave, shtetasit R. L., i është dhënë vetëm vlera 300.000 lekë. Së dyti, për pasurinë “Apartament”, si dhe për shtesën e saj, për të cilën analizohet gjerësisht në vijim, subjekti ka dhënë shpjegime në ILDKPKI, në vitin 2011, në përgjigje të pyetjeve të adresuara nga inspektorët e këtij institucioni.²⁰ Nga procesverbali rezulton se subjekti ka shpjeguar se, në vitin 1998, me shtetasin R. L., me anë të kontratave të shitjes, është bërë këmbimi i apartamenteve të përfituara nga privatizimi e të ndodhura në të njëjtin pallat [...]. ...Unë i shita shtëpinë 2+1, që sipas kontratës u vlerësua në vlerën 1.480.000 lekë dhe shtëpia që bleva, u vlerësua në kontratë në shumën 1.980.000 lekë. Meqenëse kontratat e shitblerjes së këtyre apartamenteve ishin fiktive, pasi ne bëmë këmbim të tyre, sqaroj se kam paguar shumën 300.000 lekë për një dhomë më shumë, që ka apartamenti ku jetoj aktualisht. Pra, origjina e apartamentit ku banoj është këmbimi që bëra me apartamentin e përfituar nga ligji për privatizimin. Kjo është arsyeja që e kam deklaruar si apartament të përfituar nga privatizimi. Kopje të kontratave të shitblerjes së këtyre apartamenteve po i dorëzoj në ILDKPKI [...]. Në vlerësimin e trupit gjykues, këto deklarime nuk mund të barazohen me deklarimet e bëra në mënyrë vullnetare nga subjektet deklarues në deklaratat periodike e të kenë të njëjtën vlerë provuese në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përderisa ato vijnë në përgjigje të pyetjeve dhe nevojës për shpjegime nga ILDKPKI-ja. Gjithashtu, këto deklarime, për pagesën e vlerës prej 300.000 lekë, nuk vijnë në përputhje me atë që përcakton kontrata e blerjes së pasurisë si çmim të blerjes së saj dhe që sjell si pasojë përcaktimin e diferencës në çmim mes pasurive, të vlerës prej 500.000 lekë dhe jo aq sa deklaroi subjekti.

14.3. Në Komision, subjekti ka potencuar se, referuar legjislacionit të kohës dhe praktikës noteriale, noteri ka formuluar këmbimin e banesave me kontratë shitjeje, vlerat e shënuara në kontratat e shitjes i përkasin vlerësimit të pasurive në atë kohë dhe, duke qenë se shtetasi R. L., nuk jeton më, nuk ka mundësi të provojë se këtij shtetasi i është dhënë vetëm shuma 300.000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka dhënë shpjegime edhe për regjistrimin e apartamentit të këmbyer në emër të tij, me pëlqimin e të gjithë pjesëtarëve të familjes, të cilët e kanë autorizuar si për shitjen edhe për blerjen e banesës. Për të mbështetur deklarimet e tij, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale të motrës, shtetases A. B. (T.).

14.4. Trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se ka qenë noteri ai që ka formuluar këmbimin e banesave me kontratë shitjeje. Përpos se kontrata e shkëmbimit është prej kontratave me tipare të përcaktuara qartësisht në Kodin Civil dhe e pakonfondueshme me kontrata të tjera, e në këtë kontekst pretendimi për referim në praktikën noteriale është jo relevant, duket se kontrata e

²⁰ Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 06.12.2011, pyetja nr. 2, “Sipas përgjigjes së ZVRPP-së Elbasan konfirmohet se shtëpia e deklaruar nga ana juaj, në vitin 2003, nuk është përfituar nga privatizimi, por është blerë me kontratë blerje, në shumën 1.980.000 lekë dhe ka sipërfaqe 82 m². Si e shpjegoni këtë fakt? Nëse këto veprime i keni të dokumentuara, dorëzoni kopje në ILDKPKI”.

shitjes ka qenë zgjedhje e familjes T., për të realizuar kalimin e pronësisë vetëm te subjekti, ndërsa me kontratë shkëmbimi do të fitonin të drejtën e pronësisë të gjithë bashkëpronarët²¹. Përpos kësaj, në referim të dispozitave të Kodit Civil, përkatësisht nenet: 659, 660, 663 dhe 690, trupi gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në dy kontratat noteriale të shitjes së apartamenteve. Konkretisht, në kontratën e shitjes së shtëpisë/apartamentit në pronësi të bashkëpronarëve L., pasqyrohet se këtë shtëpi, shitësit ia shesin blerësit Mustafa Turku, kundrejt vlerës 1.980.000 lekë, të cilat *i kanë marrë të gjitha në dorë jashtë zyrës së noterisë* dhe blerësi Mustafa Turku është dakord të blejë banesën përkundrejt vlerës, dhe deklaron se është likuiduar me shitësit për të gjithë shumën e shprehur në këtë kontratë, jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, në kontratën e shitjes së shtëpisë/apartamentit në pronësi të bashkëpronarëve T. pasqyrohet se këtë shtëpi shitësit ia shesin blerësit R. L., kundrejt vlerës 1.480.000 lekë, të cilat shitësit *i kanë marrë të gjitha në dorë jashtë zyrës së noterisë*. Duke llogaritur diferencën mes çmimeve të pasurive në të dyja kontratat, në shumën 500.000 lekë, deklarimet e subjektit për marrëveshje për këmbim të banesave kundrejt vlerës prej 300.000 lekë, të paguar nga familja T., përpos të pabazuara duken edhe të pakuptimta, për sa nuk ka arsye logjike që familja L., me marrëveshje të ketë pranuar shlyerje për një vlerë më të ulët se çmimi i pronës përcaktuar në kontratë. Për më tej, nga aktet në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se, pas blerjes së apartamentit në datën 30.10.1998, në datën 12.11.1998, përmes një deklarate noteriale, subjekti dhe pronarët e apartamenteve {***} dhe {****} (shtetasit A. B. dhe A. SH.), deklarojnë dakordësinë për të bërë shtesë të apartamenteve, konform projektit të miratuar nga organet kompetente dhe me shpenzimet e tyre. Në këndvështrim të kësaj dinamike, duket se me shkëmbimin e banesës, subjekti projektonte edhe shtimin e sipërfaqes së apartamentit 3+1, falë mundësisë që i ofronte apartamenti i shtetasit R. L., rrethanë faktike, e cila aq më pak e bën të besueshme ekzistencën e një marrëveshjeje me shitësin R. L., për shlyerjen e një vlere më të ulët se 500.000 lekë.

14.5. Pretendimi i subjektit, se vlera e shpenzuar për ndërtimin e shtesës së apartamentit, prej 300.000 lekësh, është përfshirë me të padrejtë në analizën financiare të vitit 2000, është po ashtu i pabazuar. Në DPV-në e vitit 2003, nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit shtesa në apartamentin e banimit, vlera e ndërtimit të saj, në shumën 299.820 lekë, si dhe detyrimi në këtë shumë kundrejt firmës ndërtuese. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 06.12.2011, i pyetur për mosdeklarimin e shtesës me sipërfaqe 14.5 m², për të cilën kishte aplikuar për legalizim pranë ALUIZNI-t dhe për vlerën e shpenzuar për ndërtimin e saj, subjekti deklaroi, se *ndërtimi i shtesës së apartamentit me sipërfaqe 14.5 m² ka filluar në dhjetor të vitit 1999, e miratuar me vendimin nr. {***}, datë 22.04.1999, të KRRT-së Elbasan; mospasqyrimi në deklaratë i kësaj shtese ka ndodhur sepse nuk ka paguar ende detyrimin ndaj firmës që ka bërë ndërtimin dhe nuk ka marrë ende dokumentin e pronësisë së shtesës; vlera e ndërtimit të saj është 299.820 lekë, detyrim i pashlyer dhe i padeklaruar, pasi nuk është bërë pronar i shtesës*. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 24.03.2016, subjekti deklaroi se *nuk e ka likuiduar detyrimin ndaj I. L., shok fëmijërie, i cili*

²¹ Kodi Civil, në nenin 757, parashikon: “Shkëmbimi është kontrata që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues tek tjetri”. Lidhur me regjistrimin e pronës apartament 3+1 në emër të tij, subjekti shpjegon: “Bërë me pëlqimin e të gjithë pjesëtarëve të familjes, të cilët më kanë autorizuar si për shitjen dhe për blerjen”. Ndërkohë, referuar prokurave të posaçme të bashkëpronarëve F. T., GJ. B. (T.), (xhaxhai dhe halla), dhe A. T. (motra e martuar), të sipërcituarit nuk i japin tagër përfaqësimi subjektit për blerjen e apartamentit 3+1. Në këtë këndvështrim, duket se 3 bashkëpronarët kanë qenë të interesuar vetëm për shitjen e pasurisë “Apartament 2+1” dhe jo për këmbimin e saj me apartamentin 3+1.

ka firmën “{***}” ShPK, dhe ka kryer punimet, detyrimi i pashlyer është në vlerën 299.820 lekë. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 24.05.2021, lidhur me deklarinin në DPV-në 2019 të detyrimit në shumën 297.760 lekë, ndaj firmës “{***}” ShPK, në ndërtimin e shtesës së ballkonit, shlyer nëpërmjet BKT-së, në datën 30.12.2019, subjektit i janë kërkuar sqarime *se kur ka ekzistuar ky detyrim, pasi në DPV-në 2018 ka deklaruar se është pajisur me certifikatë pronësie për shtesën në datën 23.10.2018*. Subjekti ka shpjeguar se në vitin 2011 ka deklaruar shtesën e apartamentit dhe detyrimin ndaj firmës “{***}” ShPK, në lidhje me detyrimin ka sqaruar se është bërë gojarisht dhe në mirëbesim, për arsye të njohjeve të hershme shoqërore dhe krushqie, dhe është shlyer në vitin 2019, sipas deklarinimit të tij.

14.6. Në përfundim të procesit të kontrollit të vitit 2011, në vendimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. {***}, datë 11.01.2012, “Për vendosjen e gjobës për shkelje të rregullave të deklarinimit të interesave privatë”, ndër moszbatimet e detyrimeve ligjore për plotësimin me korrektësi të deklaratave të pasurisë renditet edhe mosdeklarimi i detyrimit ndaj firmës “{***}” ShPK. Megjithëse i qartësuar edhe përmes këtij akti, se mosdeklarimi i detyrimeve vjen në shkelje të ligjit, në deklaratat e pasurisë të viteve 2012 – 2016, subjekti nuk deklaroi ndonjë detyrim ndaj firmës “{***}” ShPK, por e deklaroi si shlyerje detyrimi vetëm në DPV-në 2019, të dorëzuar në mars 2020, në një kohë kur procesi i rivlerësimit kishte nisur dhe subjektet ishin ndërgjegjësuar për kërkesat dhe standardet e provueshmërisë që ishin vendosur nga institucionet e rivlerësimit. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit, për të lidhur mosdeklarimin e detyrimit me marrjen e dokumentit të pronësisë, vlerësohen të pakuptimta, përpos të pabazuara, dhe deklarimi i shlyerjes së detyrimit në DPV-në 2019 nuk jep nivelin e duhur të besueshmërisë në kontekstin e rrethanave konkrete, që lidhen me avancimin e procesit të rivlerësimit.

14.7. Në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar prej Komisionit, subjekti deklaroi: [...] *Tapia për ndërtimin e këtij objekti ka dalë shumë vite më pas. Një ndër arsyet e kësaj vonese lidhet me mbylljen e firmës dhe mosgjetjen e dokumenteve preventivuese, në bazë të të cilave do të bëhej dhe pagesa për detyrimet, si ndaj firmës dhe ndaj shtetit [...]*. Përkundrejt këtij deklarimi rezulton se, me dhënien e shpjegimeve në ILDKPKI, në vitin 2011, subjekti ka dorëzuar: “Situacion punimesh përfundimtar/objekti shtesë ballkoni, e qytetarit Mustafa Turku”, të datës 21.11.2011, nënshkruar nga subjekti në cilësinë e investitorit dhe I. L., në cilësinë e administratorit të firmës “{***}” ShPK, i vulosur me vulën e shoqërisë, ku pasqyrohet vlera e punimeve 299.820 lekë (me TVSH), dhe shënimi: “Shuma nuk është likuiduar nga investitori, pasi nuk është marrë leja e shfrytëzimit për të bërë hipotekimin e ndërtimit, shumën do të likuidohet me të bërë lejen e shfrytëzimit nga Bashkia Elbasan”. Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka dorëzuar kopje të praktikës së legalizimit të shtesës, ndër to edhe dokumentin me të njëjtën përmbajtje si dokumenti i dorëzuar me shpjegimet në ILDKPKI, në vitin 2011, i nënshkruar nga I. L., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, i vulosur me vulën e shoqërisë, i cili nuk ka datë. Përpos se nuk duket që subjekti të ketë qenë në vështirësi për gjetjen e dokumenteve preventivuese, nuk duket që në to të referohet situata e plotë për ndërtimin e shtesës së apartamentit, në vështirësi të krahasuar të tyre me aktet e tjera të administruara. Konkretisht, në akt-ekspertimin e hartuar nga inxhinierë, e administruar në dosjen e ALUIZNI-t, përshkruhet se, *në pjesën e pasme të pallatit, duke përfshirë edhe kafazin e shkallës, është bërë një shtesë 4-katëshe me përmasa 6x2.4, me sipërfaqe ndërtimi 14.40 m² në çdo kat, që përfaqëson një ambient shtesë banimi, që shtetasit Mustafa Turku dhe A. B., e kanë adaptuar në aneks gatimi dhe banjë*, ndërsa në dokumentet *situacion punimesh përfundimtar* nuk pasqyrohen elemente/vlerë punimesh specifike për ambientin e dytë. Përpos sa më sipër, referuar procesverbalit

të ILDKPKI-së, në vitin 2011, lidhur me mospërputhjet e sipërfaqes së apartamentit (70 m², deklaruar në DPV-në 2003, përkundrejt 82 m² të konfirmuar nga ZVRPP-ja Elbasan), subjekti deklaroi: [...] *Tapia e re e këtij apartamenti është bërë pasi rregullova shtëpinë, duke mbyllur një pjesë të tarracës (pa shtesën 14.5 m²), në total u regjistrua në ZVRPP me sipërfaqe 82 m². Pra, fillimisht ky apartament ishte me sip. 70 m² dhe pas rregullimit e regjistrova në ZVRPP me sipërfaqe 82 m² duke përfshirë edhe një pjesë të tarracës që e mbylla [...]*. Pa dhënë shpjegime për vlerën e këtyre punimeve të tjera, nëse ishin kryer po nga shoqëria “{***}” ShPK dhe a përfshiheshin në *situacion punimesh përfundimtar me objekt shtesë ballkoni, e qytetarit Mustafa Turku*. Në këto rrethana ligjore dhe faktike, dokumentacioni i depozituar prej subjektit në Komision: deklarata noteriale e vitit 2023, e shtetasit I. L., i cili deklaroi se vlerën prej 300.000 lekësh të kostos së punimeve për ndërtimin e shtesës ia ka kërkuar subjektit të rivlerësimit në vitin 2019, kur duhet të legalizonte ndërtimin, fatura tatimore e lëshuar nga “{***}” ShPK, në datën 26.12.2019, për *situacion punimesh* me vlerë 297.660 lekë (me TVSH), si dhe mandati i BKT-së datë 30.12.2019, për kalimin prej subjektit në llogarinë bankare të “{***}” ShPK, me shënimin: “Ky mandat do të shërbejë si provë për çdo pretendim në të ardhmen”, duket të vijnë në mbështetje të pretendimeve të subjektit për mosshlyerje të detyrimit në vitin 2000, në mungesë të deklarimeve përkatëse që duhet të pasqyronin këtë marrëdhënie detyrimi në deklaratat periodike të pasurisë deri në vitin 2016 dhe më tej.

14.8. Subjekti pretendoi se përlllogaritja e të ardhurave dhe e shpenzimeve të prindërve të tij është joproporcionale. Sipas subjektit, babai ka punuar në detyrë shtetërore për 42 (dyzet e dy) vjet, me profesion shofer, nëna në punë të ndryshme me të ardhura të konsiderueshme, me mundësi kursimi për këto vite pune, por pa referuar ndonjë shifër dhe pa paraqitur ndonjë dokumentacion lidhur me kursime të krijuara prej prindërve në kohë. *Së pari*, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të pasurisë “Apartament” dhe as të shtesës së ndërtuar në vitin 2000. *Së dyti*, niveli i të ardhurave të prindërve të subjektit pensionistë, babai prej datës 19.12.1993 (ku deri në vitin 1998 ka përfutur pension pleqërie me masë mujore nga 2753 deri në 4756 lekë); nëna prej datës 01.01.1992 (ku deri në vitin 1998 ka përfutur pension pleqërie, me masë mujore nga 1365 deri në 4764 lekë), jo vetëm bëjnë të duket i vështirë përballimi i shpenzimeve të jetesës, por nuk përjashtojnë përdorimin edhe të kursimeve të mundshme të krijuara prej tyre gjatë periudhës së punësimit. Përpos kësaj, referuar deklarimeve të subjektit në pyetësorë lidhur me një tjetër pasuri, truall me sipërfaqe 243 m², blerë prej tij në vitin 1996, *me qëllim ndërtimin e një banese, pasi në apartamentin 2+1, të përfutur nga privatizimi, jetonin më shumë se 2 kurora, por duke qenë se prindërit në vitet në vijim filluan të kishin probleme shëndetësore dhe nevojë për përkujdesje, vazhduam jetën si një familje e vetme dhe nuk ndërtuam kurrë në tokën e blerë*, duket se shpenzimet jetike për prindërit e subjektit të përfshinin edhe ato për kujdesin shëndetësor. Subjekti pretendoi gjithashtu se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga puna e motrës për atë periudhë që ajo ka kontribuar. Nga aktet në fashikuj rezulton se motra e subjektit ka qenë e përfshirë në gjendjen familjare deri në vitin 1995 (martuar në shtator të vitit 1995), ka pasur të ardhura vetëm në një vit, në vlerë e peshë të papërfillshme për ekonominë familjare, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar.

14.9. Lidhur me pretendimin se shpenzimet jetike për familjen e tij janë vlerësuar në nivel të lartë, pa mbajtur në konsideratë që të gjithë pjesëtarët kanë qenë një familje e vetme, e pandarë, që jetonin në të njëjtën banesë prej shumë vitesh, kishin kontributet e tyre me të ardhura nga pagat dhe

pensionet, dhe nuk është marrë në konsideratë se niveli i jetesës në qytetin e Elbasanit nuk është si në kryeqytet, trupi gjykues vlerëson si vijon.

14.9.1. Komisioni, fillimisht në analizën financiare nuk ka përfshirë si të ardhura pensionet e prindërve të subjektit të rivlerësimit, duke i konsideruar si të barabarta me shpenzimin jetik të tyre. Nga vlerësimi i situatës, pas kërkesës së subjektit, duke arsyetuar sipas qëndrimit të Kolegjit²², Komisioni ka llogaritur shpenzimet për jetesë në familjen e subjektit, me 4 (katër) persona, në masën 30% referuar të ardhurave të subjektit dhe të ardhurave të prindërve nga pensionet si shpenzime në masën 66 % referuar masës së pensionit. Trupi gjykues, së pari, çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit, të referuar edhe prej Komisionit, ku është arsyetuar se: *“Organet e rivlerësimit sigurisht që duhet të kryejnë një analizë logjike e të arsyeshme për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve në raste në të cilat ndërthuren elemente të tjera, duke mbajtur në çdo rast në konsideratë se masa prej 66% e shpenzimeve në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000, do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik, që shkojnë përafërsisht në vlerën rreth 800 USD në vit, sipas referencës së Bankës së Shqipërisë, dhe duke e vlerësuar këtë orientim në drejtim të përcaktimit të një analize logjike dhe jo si një referim ligjor i detyrueshëm për zbatim”*. Në rastin konkret, fakti që të dy prindërit e subjektit ishin pensionistë me të ardhura vjetore nën shifrën e referuar në qëndrimin e Kolegjit (shih paragrafin më lart) dhe në familjen e ngushtë të subjektit bënë pjesë edhe dy fëmijët e tij të mitur (djali i lindur më 12.05.1993 dhe vajza e lindur më 25.02.1998), mbështesin qëndrimin e mbajtur prej Komisionit, se shpenzimet për jetesë të prindërve nuk mund të ishin në masën 30% të të ardhurave të tyre prej pensionit dhe as se vlera prej 30% e të ardhurave të subjektit do të mbulonte shpenzimet për të gjithë familjen prej 6 (gjashtë) personash.

14.10. Në përfundim të sa analizuar më sipër, lidhur me pasurinë “Shtëpi banimi/apartament 3+1+shtesa”, me sipërfaqe 84.40 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Elbasan, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë se: **(i)** Shtetasit R. L., nuk i është dhënë shuma 500.000 lekë, sa rezulton diferenca e çmimeve në kontratat respektive të shitblerjes së apartamenteve të datës 30.10.1998. **(ii)** Vlerën prej 299.820 lekësh të punimeve të ndërtimit të shtesës së apartamentit me sipërfaqe prej 14.39 m², nuk e ka shlyer në vitin 2000, kur punimet kanë përfunduar, sipas deklarimit të tij. Për rrjedhojë, në analizën financiare, duke ngarkuar subjektin e rivlerësimit me shpenzime për këtë pasuri sipas vlerave të mësipërme, të njëjtat me ato që ka konkluduar Komisioni, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 529.053 lekësh për krijimin e kësaj pasurie dhe ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Pasuria “Apartament banimi” (garsoniere), me sipërfaqe 33,84 m², në {}, Kavajë, në emër të bashkëshortes së subjektit, përfituar sipas kontratës së shitblerjes datë 18.11.2005***

15. Në deklaratën e pasurisë vetting, lidhur me këtë pasuri, subjekti deklaroi: *Apartament banimi (garsoniere), me sipërfaqe 33,84 m², në {***}, Kavajë, regjistruar me Certifikatë Pronësie nr. {***}, datë 21.11.2005, me nr. {***} pasurie, z. k. {***}, vol. {***}, f. {***}, në emër të bashkëshortes së subjektit, përfituar sipas Kontratës së Shitblerjes datë 18.11.2005. Vlera e pasurisë 300.000 (treqind mijë) lekë, është vlera e kostos reale të ndërtimit të garsonierës. (Garsonierja i është dhënë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga i vëllai D. B., në këmbim të pjesës që bashkëshortja i*

²² Sipas vendimit të Kolegjit nr. 15/2021, paragrafi 21.41.

*fali për shitjen e banesës së familjes). E konfirmuar me Kontratë Shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2005. Burimi i krijimit: dhënë nga i vëllai, ndonëse veprimi është bërë me akt shitje për efekt dokumentimi. Pjesa takuese: 100% në pronësi të bashkëshortes.*

16. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të justifikojë me dokumentacion justifikues përfitimin e pasurisë në pronësi të bashkëshortes, sipas nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe rezulton në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në shumën (-) 611.683 lekë. Ky konkluzion është bazuar në përfundimet e paraqitura në mënyrë të përmblendhur si vijon:

(i) Komisioni ka vlerësuar t'i qëndrojë konstatimit fillestar për llogaritjen e vlerës së garsonieres sipas kostove të EKB-së, për faktin se mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklarimet e pasakta dhe të ndryshme në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe ato gjatë hetimit administrativ mbi përfitimin e kësaj pasurie, të cilat nuk gjetën zbatim as në ndonjë dokument të kohës apo në kontratën e shitblerjes së shtëpisë së prindërve të bashkëshortes, e çuan trupin gjykues në konkluzionin se nga tërësia e tyre nuk u arrit të provohej në ndonjë formë të dokumentuar dhurimi i kësaj pasurie, e cila është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij.

(ii) Ndërtimi ishte kryer nga ndërtuesit rreth viteve 2002 – 2003 dhe vetë objekti ishte kolauduar në shtator të vitit 2003, ndaj vlera e pasurisë sipas kostos së ndërtimit të EKB-së për vitin 2003 ka rezultuar në shumën 837.709 lekë. Nga analiza financiare, sipas kësaj vlere, ku janë vendosur shpenzimet për arredim, në vitin 2005, në shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë, sipas deklarimit në pyetësorin standard, si dhe janë përfshirë edhe të ardhurat nga pensionet e prindërve të subjektit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2005, në shumën (-) 611.683 lekë.

17. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është provuar se ky ndërtim nuk është bërë prej tij, por nga D. B., (vëllai i bashkëshortes), se nuk ka pasur kundërshti ndërmjet deklarimeve periodike dhe deklarimit në deklaratën *vetting* lidhur me këtë pasuri. Sipas tij është e dukshme që pamundësia financiare në vitin 2005, në shumën (-) 611.683 lekë vjen për shkak të një shpenzimi të paqenë, vlerës së ndërtimit sipas kostos së EKB-së në shumën 837.709 lekë.

18. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për llogaritjen e vlerës së kësaj pasurie sipas kostos së ndërtimit të EKB-së për vitin 2005, nuk gjen bazueshmëri në provat e administruara në fashikuj, për rrjedhojë, nuk është i drejtë. Në vijim analiza e detajuar dhe vlerësimi i trupit gjykues.

18.1. Së pari, nga aktet në fashikull dokumentohet si vijon:

(i) Në DPV-në 2005, subjekti deklaroi: *Në formularin e deklarimit të interesave privatë, apartament banimi [garsoniere], me sipërfaqe 33 m², në {***}, datë 21.11.2005, vlerë 300.000 lekë, pjesë takuese 100%. Në formularin e të dhënave që nuk publikohen, apartament banimi (garsoniere), {***} (në emër të bashkëshortes) dhe në kolonën “nr. i regj. publik, nr. i kontratës noteriale” deklaroi nr. i pasurisë {***}, Kavajë.*

(ii) Në DPV-të e viteve 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010, subjekti deklaroi të ardhura nga garsonierja në vlerën 180.000 lekë për çdo vit.

(iii) Referuar kontratës së shitjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2005, shitësi D. B., i shet S. T., (bashkëshortja e subjektit), pasurinë “Apartament” me sipërfaqe 33.84 m², me kuota të

pjesëmarrjes 4.8%, kundrejt vlerës 300.000 lekë²³. Blerësja S. T., deklaron se është dakord ta blejë pasurinë kundrejt kësaj vlere, ta marrë në dorëzim në gjendjen që ajo ndodhet pa shfaqur pretendime mbi gjendjen e saj. Palët me vullnetin e tyre të lirë *deklarojnë se janë shlyer paraprakisht me njëra-tjetrën jashtë zyrës noteriale*. Kontrata ka bashkëlidhur certifikatën e pronësisë në emër të D. B., lëshuar nga ZVRPP-ja në datën 02.06.2004, hartën treguese të regjistrimit dhe kartelën e pasurisë.

(iv) Referuar kontratës së shitblerjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2004, D. B., D. B., T. B., (respektivisht i ati, vëllai dhe bashkëshortja e vëllait, të bashkëshortes së subjektit) dhe S. T., në cilësinë e palës shitëse, i shesin shtetas A. LL., pasurinë “Apartament” me sipërfaqe 68 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, pallati {***}, në Elbasan, në shumën 2.700.000 lekë. Shuma deklarohej nga palët e likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale.

(v) Në kontratë pasqyrohet se pronësia mbi këtë objekt vërtetohet nga vërtetimi hipotekor nr. {***}, datë 14.01.2004; origjina e regjistrimit të pasurisë nr. hipotekor {***}, datë 14.12.1993, pjesë përbërëse e kontratës bëhet vërtetimi hipotekor dhe harta treguese, të cilët nuk rezultojnë të depozituar bashkë me kontratën.

(vi) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 14.09.2006, me kërkuese S. B. (T.), objekt vërtetimi i faktit juridik të trashëgimisë ligjore, ka vendosur *të vërtetojë faktin juridik se trashëgimtarë ligjorë të së vdekurës M. B. janë bashkëshorti i saj, DH., si dhe fëmijët, D. dhe S. T., të cilët trashëgojnë nga 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore*. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 29.09.2006.

(vii) Gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaron: (i) në përgjigje të pyetësorëve: [...] *Bashkëshortja ka qenë bashkëpronare në banesën apartament [2 + 1 + aneks] të prindërve të saj, së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes (babai, nëna, vëllai dhe kunata), pronë e shitur më parë në vitin 2004, dokument të cilin jua kam vënë në dispozicion në deklaratimet e mëparshme. Pas vdekjes së nënës së saj, shtëpia është shitur. Me vullnetin e saj, bashkëshortja pjesën e saj takuese nga nëna ia dha të vëllait, shtetasit D. B., i cili përfitoi çmimin e shitjes së banesës në tërësi. Nga ndërtimi i bërë në {***} nga i vëllai, ai i dha asaj garsonieren e përmendur me sipër në gjendje karabina (të pambaruar), e përfunduar dhe e plotësuar më pas gradualisht. Veprimi i kryer midis tyre është bërë me akt shitblerjeje, ndonëse nuk janë paguar lekë, por vlera e saj është kosto ndërtimi. Vlera që bashkëshortja ka përfutur është garsonierja dhe, sikurse është deklaruar, vlera e saj ka qenë vlerësuar 300.000 lekë. Kjo mënyrë ndarjeje ka qenë midis pjesëtarëve të familjes së bashkëshortes... Referuar kontratës së shitjes datë 18.11.2005 rezulton që më është dorëzuar garsonierja nga kunati. Në lidhje me përfundimin e objektit, e kam marrë të përfunduar si karabina, të suvatuar. Fillimisht, unë kam vendosur vetëm tri dyer dhe një dritare të vogël tualeti, që në total kanë kushtuar 30.000 lekë. ...Objekti mban numrin e kontratës {***} me OSHE-në. Nuk e disponoj kontratën fizikisht, por vetëm librezën e pagesës rregullisht të dritave. Konstatoj se në kontratën e banesës sime në Kavajë, mbiemri im nuk e di pse është shënuar “M.”, pra jo Mustafa Turku, por Mustafa M., ... Në banesën*

²³ Nga informacioni i ASHK-së kanë rezultuar disa veprime shitblerje të një toke arë në {***}/Kavajë dhe një leje ndërtimi: 250 m² u janë shitur në vitin 2001, në vlerën 100.000 lekë, katër blerësve (ku përfshihet dhe shitësi), secili me 1/4 pjesë, njëri prej tyre D. B./vëllai i bashkëshortes së subjektit. Prona është regjistruar në emër të këtyre 4 shtetasve sipas certifikatës së pronësisë datë 08.06.2001. Këta shtetas, në cilësinë e investitorit, në sipërfaqen 250 m² kanë ndërtuar godinën prej 5 katesh, me vlerë investimi 30.000.000 lekë, me shoqërinë e ndërtimit “{***}” ShPK. Sipas kontratës së pjesëtimit të pasurisë me nr. {***}, datë 26.04.2004, shtetasi D. DH. B., rezulton pronar i pasurisë “Apartament” nr. {***}, me sip. 33.84 m², sipas certifikatës së pronësisë datë 02.06.2004.

garsoniere në {***}, Kavajë, kam jetuar pjesërisht që nga viti 2005 gjatë fundjavave. [...] (ii) Në përgjigje të rezultateve të hetimit: [...] për garsonieren nuk është paguar asnjë lek, pasi ajo i është dhënë nga i vëllai, në mirënjohje që bashkëshortja ime i fali pjesën e saj takuese nga apartamenti, që u shit më parë, ku ajo ishte bashkëpronare. Vlera prej 300.000 lekësh, e vendosur në kontratën e shitjes, është vlera e ndërtimit si karabina e këtij objekti. Ana formale e aktit të dhënies së objektit është e konfirmuar me akt shitjeje, por që në fakt është dhurim i bërë nga vëllai për të motrën. Ndërtimi i garsonieres nuk ka filluar në vitin 2005, por në vitin 2000, dhe kostoja e ndërtimit duhet të marrë për bazë çmimet e atij viti dhe jo të pesë viteve më pas. [...]

18.2. Nga aktet siç janë referuar më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje disa konstatime si vijon. Së pari, referuar kontratës së shitjes së apartamentit të familjes së bashkëshortes së subjektit në Elbasan, origjina e regjistrimit të pasurisë nr. hipotekor {***}, datë 14.12.1993, e asocionon fitimin e kësaj pasurie me periudhën e privatizimit të banesave shtetërore²⁴. Nga çmimi i shitjes së apartamentit, si pjesë takuese e nënës së bashkëshortes së subjektit do të rezultonte 900.000 lekë (2.700.000 lekë : 3 = 900.000 lekë, duke konsideruar si përfitues nga privatizimi i apartamentit babain, nënën dhe vëllain e bashkëshortes së subjektit²⁵). Për rrjedhojë, nga çmimi i shitjes së apartamentit, pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit rezulton 300.000 lekë (nga ndarja e shumës prej 900.000 lekë në tri pjesë, mes trashëgimtarëve të së ndjerës). Së dyti, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja, në DPV-në 2004, nuk deklarojnë të ardhura nga shitja e apartamentit në Elbasan dhe në DPV-në 2005 për pasurinë “Garsoniere” nuk deklarohet burimi i krijimit dhe as ekstremitetet e kontratës së shitjes së kësaj pasurie. Në analizë harmonike të të dhënave të rezultuara nga provat e administruara, për pasurinë “Garsoniere” në Kavajë, duket të gjejnë bazueshmëri pretendimet e subjektit për kthim nga vëllai i bashkëshortes së subjektit, te kjo e fundit, të pjesës takuese të çmimit të shitjes së apartamentit në Elbasan. Konsideruar deklarin e blerëses/bashkëshortes së subjektit në kontratën e shitjes, se është dakord ta blejë pasurinë kundrejt vlerës 300.000 lekë, ta marrë në dorëzim në gjendjen që ajo ndodhet, pa shfaqur pretendime mbi gjendjen e saj, dhe vlerën provuese të këtij akti në kuptim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vlerëson se vlera e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie ka qenë në shumën 300.000 lekë. Trupi gjykues nuk e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit që e ka ngarkuar subjektin me shpenzim për blerjen e tij sipas çmimeve të EKB-së, duke qenë se kjo vlerë është e ndryshme nga ajo që palët kanë përcaktuar në kontratën e shitjes, aq më tepër në kushtet kur çmimi i ulët në kontratën e shitjes, merr kuptim në kuadër jo vetëm të marrëdhënieve të posaçme, motër-vëlla, por edhe në kontekstin e rrethanave të mësipërme, nga të cilat nuk rezulton se bashkëshortja e subjektit të ketë përfituar realisht pjesën takuese nga shitja e pjesës që i takonte nga trashëgimia ligjore e nënës së saj. Në të njëjtën linjë arsyetimi, trupi gjykues nuk vlerësoi si të besueshme pretendimet e subjektit se ai nuk ka financuar aspak për blerjen e kësaj pasurie, përderisa palët në kontratë kanë nënshkruar shlyerjen e çmimit të përcaktuar në të, prej 300.000 lekësh.

²⁴ Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 10, datë publikimi 31.12.1992, në nenin 9 parashikon: “Banesat që privatizohen, do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij. Banesa që përdoret nga disa qiramarrës, kalon në pronësi të çdo qiramarrësi, në bazë të pagesës që ka në kontratën e qirasë. Kur qiramarrësit bien dakord midis tyre, banesa mund të kalojë tërësisht në pronësi të njërit qiramarrës”.

²⁵ Sipas certifikatës së martesës, lëshuar nga ZGJC Elbasan, në datën 25.01.2023, subjekti dhe bashkëshortja kanë lidhur martesë në datën 20.07.1990.

18.3. Për sa analizuar dhe vlerësuar më lart, duke gjetur të bazuara pretendimet e subjektit, se prej tij dhe personit të lidhur/bashkëshortes janë kryer shpenzime vetëm për arredimin e pasurisë “Garsoniere”, me punime të pakryera (vendosje të dyerve dhe dritareve në vlerën 30.000 lekë], trupi gjykues bëri korrigjimet në analizën financiare të Komisionit për këtë pasuri, duke përfshirë përfshirjen e vlerës së investimit sipas kostos së ndërtimit të EKB-së dhe duke e përfshirë vlerën prej 300.000 lekësh.

18.4. Në analizën financiare të Komisionit konstatohet se është konsideruar një vlerë prej 751.592 lekësh depozitim/transferim i kryer nga subjekti në datën 21.10.2005, në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, duke konkluduar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 611.683 lekë, për krijimin e pasurisë “Garsoniere” në {***}, në vitin 2005, si dhe (-) 500.000 lekë për krijimin e gjendjes *cash*, po atë vit. Duke konstatuar se shuma e mësipërme është transferim nga një llogari tjetër bankare e subjektit të rivlerësimit, e për rrjedhojë jo e krijuar në vitin 2005, por e mbartur nga viti 2004, rrethanë e pranuar në narrativë e arsytimit të vendimit edhe nga Komisioni, por e pa pasqyruar në të njëjtën mënyrë në analizën financiare²⁶, në Kolegj u saktësua analiza financiare edhe në këtë aspekt. Nga korrigjimet e referuara më sipër, analiza financiare e Komisionit ndryshon nga balanca negative, në balancë pozitive. Për rrjedhojë, në vitin 2005, për kryerjen e investimit për krijimin e pasurisë “Garsoniere” në {***}, si dhe për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit rezulton me mjaftueshmëri burimesh financiare të ligjshme.

Pasuria automjet tip “Mercedes Benz”, me targë {}***

19. Lidhur me këtë pasuri, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti deklaron: *Autoveturë e markës “Mercedes Benz”, tip 200 D, me targë {***}. Blerë me këste, me kursime nga paga dhe të familjes, në shumën 700.000 lekë, në bazë të kontratës shitje automjeti, vërtetuar nga noteri me nr. {***}, datë 24.02.2000. Burimi i krijimit: kursimet nga pagat dhe shlyer me këste. Vlera: 700.000 lekë. Pjesa: 100%.*
20. Komisioni për këtë pasuri ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting* dhe se ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është bazuar në përfundimet e paraqitura në mënyrë të përmbledhur si vijon:
 - (i) Burimi i krijimit të pasurisë, deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimeve të dhëna, është i ndryshëm nga ai i deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklarimet e pasakta dhe kontradiktore në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ mbi burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e saj, duke e ndryshuar atë, si dhe pamundësia për të provuar një burim të ligjshëm të të ardhurave për likuidimin e shumës sipas kontratës, e bëjnë deklarin e subjektit të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
 - (ii) Nga analiza kumulative për periudhën 1993 – 2000 (viti i krijimit të pasurisë), duke përfshirë edhe të ardhurat e prindërve nga pensioni, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me të ardhura nga burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën (-) 372.019 lekë.
21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shpjeguar në Komision se ky automjet me vlerë 700.000 lekë është blerë nga babai i tij, me të ardhura të siguruara nga vetë babai dhe se shuma për blerjen e mjetit

²⁶ Shih paragrafët nr. 21.11 dhe nr. 23.6. të vendimit të Komisionit.

nuk është dhënë menjëherë, por me këste, siç ka deklaruar në DPV-në 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Sipas subjektit, përfshirja në analizën financiare të vitit 2000 e kështit të paguar vite më vonë, pasjell balancën negative të konstatuar nga Komisioni dhe, se referuar analizës kumulative të viteve 1993 – 2000, po të zbritet vlera e kështit që nuk është paguar në vitin 2000, nuk ka pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme.

22. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë se ky automjet, me vlerë 700.000 lekë, është blerë nga babai i tij me të ardhura të siguruara nga vetë ai dhe se çmimi i tij është paguar me këste, në kundërshtim me sa parashikon kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, datë 24.02.2000. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues të Kolegjit për këtë pasuri mbështetet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.

22.1. Së pari, nga aktet në fashikuj rezulton e dokumentuar sa vijon:

(i) Për herë të parë, subjekti e deklaroi këtë pasuri në DPV-në 2003, si vijon: *Autoveturë “Mercedes Benz” 200 D-***}. Vlera: 0.55 milion; pjesa që zotëron: 100%; burimi i krijimit: kursime nga paga. Vendndodhja: Drejtoria Rajonale Kontrollit të automjeteve Elbasan.*

(ii) Në procesverbalin e ILDKPKI-së, mbajtur në datën 24.03.2016, për pyetjen: “Saktësoni sa automjete keni në pronësinë tuaj dhe familjarëve apo dhe në përdorim deri në datën 31.12.2014”, subjekti deklaroi se deri në këtë datë, prej 16 vjetësh ka pasur në pronësi automjetin tip “Benz” me targa {***} dhe nuk ka pasur automjet tjetër në përdorim.

(iii) Referuar “Kontratë shitje automjeti”, vërtetuar nga noteri me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.02.2000, paraqitur nga subjekti si dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, pasqyrohet se përfaqësuesi i shitësit A. B., shtetasi M. C.,²⁷ ia shet këtë automjet blerësit/subjektit, në vlerën 700.000 lekë dhe deklaroi se *e ka marrë të gjithë shumën në dorë nga blerësi, i cili deklaroi se e ka marrë në dorëzim makinën.*

(iv) Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, deklaratën noteriale të shtetasit M. C.²⁸, i cili deklaroi se automjetin ia ka shitur shtetasit Mustafa Turku, në vitin 2000, në vlerën 700.000 lekë, por për shkak të miqësisë dhe të qenët banorë në të njëjtin qytet, pagesa është bërë në marrëveshje që në momentin e shitjes janë paguar 550.000 lekë dhe shuma e mbetur t’i jepej më pas, pa një afat të caktuar, dhe mesa kujtohet është shlyer pas vitit 2003.

22.2. Gjatë hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, në mënyrë të përmblodhur, subjekti deklaroi: (i) *Në përgjigje të pyetësorit standard:* në vitin 2000 është blerë makina “Mercedes Benz”, nga babai, në shumën 700.000 lekë. (ii) *Në përgjigje të pyetësorit 2:* në DPV-në 2003 ka shënuar shumën e dhënë shitësit në atë kohë prej 550.000 lekësh dhe 150.000 lekë janë dhënë pas deklarimit. Në DPV-në 2003 ka deklaruar vlerën e shpenzuar, në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar shumën e paguar prej 700.000 lekësh. Për rrjedhojë, nuk ka mospërputhje mes dy deklarimeve, në të cilat burimi për krijimin e pasurisë është deklaruar: *kursime nga paga*, duke shtuar në deklaratën e pasurisë *vetting* edhe termin “shlyer me këste”. (iii) *Në parashtrim:* makina është blerë nga babai me të ardhura të siguruara prej tij. Pas daljes në pension, në vitin 1994 deri në vitin 2004, babai ka punuar dhe, për shkak të reputacionit si shofer dhe shkallës së gjerë shoqërore të njohjes, ai pati mundësinë për të punuar pranë disa subjekteve

²⁷ Sipas prokurës së posaçme nr. {***}, datë 24.11.1999.

²⁸ Nr. {***}, datë 02.08.2023, noter K. K.

private, duke marrë të ardhura të padeklaruara. Këtë mjet e ka në përdorim dhe e ruan në respekt të tij. *Lekët e mjetit nuk janë dhënë menjëherë, por me këste.*

22.3. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti me deklaratimet në Komision ka synuar të ndryshojë sa deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në DPV-në 2003. Konkretisht, sa i përket burimit financiar për krijimin e pasurisë, deklarin "kursime nga paga", subjekti e ka ndryshuar në "blerë nga babai me të ardhura të tij", në përpjekje për t'iu përgjigjur barrës së provës, *për pamundësi financiare në shumën (-) 549.975 lekë*, për krijimin e kësaj pasurie. Në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, subjekti nuk deklaroi ndonjë detyrim ndaj shitësit/përfaqësuesit të tij dhe në kontratën e shitjes përfaqësuesi i shitësit deklaroi se e ka marrë në dorë të gjithë shumën prej 700.000 lekësh. Për rrjedhojë, në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, se shuma 700.000 lekë është *paguar me këste*, pa deklaruar numrin e kësteve, shumat respektive dhe datat e shlyerjes së tyre, konstatohet i pasaktë. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se me deklarin në deklaratën e pasurisë *vetting - paguar me këste* - subjekti ka synuar të përputhë këtë deklarin me deklarin në DPV-në 2003, ku si vlerë e blerjes së automjetit deklarohet shuma, e cila gjatë procesit të rivlerësimit pretendohet si kësti i parë. Përpos sa më sipër, në këndvështrim të sjelljes së subjektit si pronar nga momenti i blerjes së automjetit, kryerja e veprimeve për blerjen e tij nga vetë subjekti, fakti që vetëm subjekti rezultoi pronar dhe përdorues i automjetit (sipas të dhënave të sistemit të AMF-së dhe sipas vetë deklarit të subjektit në ILDKPKI), bëjnë të pabesueshme pretendimet si për blerjen, ashtu edhe për përdorimin e këtij automjeti nga babai i subjektit.

22.4. Në rrethanat faktike dhe ligjore analizuar si më lart, trupi gjykues arrin në përfundimin se, lidhur me pagesën e çmimit të kësaj pasurie, të shlyer në vitin 2000, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta në deklaratën e pasurisë *vetting*, si edhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 231.621 lekësh, përkundrejt balancës negative prej (-) 353.574 lekësh, që ka konkluduar Komisioni. Kjo diferencë vjen pasi, megjithëse pa kërkim të subjektit, Kolegji në kontrollin e analizës financiare të Komisionit, në qëndrim garantist, ka përfshirë të ardhurat nga puna të subjektit për periudhën 1992 – 1993, të padokumentuara në dokumentacionin e administruar, por duke iu referuar pagës së prokurorëve në funksion në atë periudhë. Pavarësisht vlerës më të ulët të balancës negative, edhe për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016.

Pasuria "Automjet", tip "Opel Corsa 1.2", me targë {}***

23. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me këtë pasuri, subjekti deklaroi: *Autoveturë "Opel Corsa 1.2", blerë në shumën 700.000 lekë, sipas Kontratës së Shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2009. Burimi i krijimit: blerë me paratë e shitjes së automjetit tip "Renault Clio", në shumën 400.000 lekë dhe shuma shtesë prej 300.000 lekësh është nga kursimet nga paga. Pjesa takuese 100% në pronësi të bashkëshortes. Gjithashtu, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, bën të njëjtin deklarin për këtë pasuri duke deklaruar si burim krijimi: nga shitja e makinës "Renault" dhe nga të ardhurat nga paga.*
24. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe se ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në përfundime, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- (i) Subjekti rivlerësimi ndryshon deklaratimet e tij, vlera e përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2008, jo vetëm nuk është deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie, por edhe është e dyshimtë.
- (ii) Edhe nëse do të konsideroheshin në analizën financiare si burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Renault”, me vlerë sa ajo e blerjes, prej 300.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte në pamundësi financiare për krijimin e pasurisë në shumën (-) 287.766 lekë.
25. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e blerjes së automjetit “Opel Corsa”, shuma prej 700.000 lekësh, është rezultat i shitjes së automjetit “Renault Clio” në shumën 400.000 lekë, duke i shtuar shumën 300.000 lekë, kursime nga paga, si dhe të ardhura të tjera të familjes. Mosdeklarimi si gjendje *cash* i shumës së shitjes së automjetit “Renault Clio” nuk ka të bëjë me mosdeklarimin e saj, pasi një gjë e tillë është pasqyruar në DPV-në 2009. Në DPV-në 2008 është deklaruar vlera e shitjes së këtij automjeti, prej 400.000 lekësh, e cila ka qenë gjendje *cash* në shtëpi dhe më pas është përdorur për të blerë automjetin tip “Opel Corsa”, në vitin 2009. Sipas subjektit, automjeti “Renault Clio” u shit më shtrenjtë sesa ishte blerë, pasi blerësi kishte pasur një mjet të tillë, nuk e kishte më dhe ia kishte kërkuar subjektit mjetin. Në hetimin financiar nuk janë futur veç të ardhurave të subjektit, edhe ato të bashkëshortes dhe nënës së tij.
26. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mbajtur në konsideratë qëndrimin e Kolegjit²⁹, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit, që shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “Renault Clio”, në vitin 2008, është përdorur për blerjen e automjetit në analizë, gjejnë bazueshmëri nga analizimi në harmoni i fakteve të rezultuara nga provat e administruara. Në vijim, analiza dhe vlerësimi i trupit gjykues.
- 26.1. Së pari, nga aktet në fashikuj rezulton e dokumentuar si vijon:
- (i) Në DPV-në 2009, subjekti deklaron blerjen e automjetit tip “Opel Corsa”, me targë {***}³⁰, në shumën 700.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2009.
- (ii) Në DPV-në 2008, subjekti deklaron shitjen e automjetit tip “Renault”, me kontratën shitblerje nr. {***}, datë 02.11.2008, në shumën 400.000 lekë, për të cilin në DPV-në 2007 deklaron blerjen në shumën 300.000 lekë, në emër të bashkëshortes, blerë në datën 06.09.2007, shitës shoqëria “{***}” ShPK.
- (iii) Sipas informacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja³¹: (i) Automjeti tip “Renault Clio”, i cili ka kushtuar 136.039 lekë në total, është blerë nga shtetasja S. T., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në shumën 252.000 lekë dhe është shitur prej saj në shumën 400.000 lekë, me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 02.11.2008. (ii) Automjeti tip “Opel Corsa” është blerë nga bashkëshortja e subjektit me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2009 kundrejt shumës 700.000 lekë, e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale.

²⁹ Vendimi nr. 4 (JR), datë 30.01.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Marjana Shegani (Dedi), paragrafi 12.7 dhe vijues, ku mbahet qëndrim se: [...] trupi gjykues çmon se kjo situatë duhet të vlerësohet objektivisht dhe mosdeklarimi i gjendjes *cash*, në DPV-në e vitit 2013, e cila është përdorur në ditët e para të vitit 2014, të konsiderohet si një pasaktësi që nuk duhet të afektojë vlerësimin e burimeve të kësaj pasurie. [...]

³⁰ DPSHTRR-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.03.2021, informon se, sipas historikut të targave të automjetit, ky automjet ka pasur targën {***} deri në datën 04.05.2015, kur është pajisur me targën {***}, për arsye të dëmtimit të targave.

³¹ DPSHTRR-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2023, ka dërguar informacion për automjetin “Renault Clio”, viti 1996, me targë {***}, nga ku rezulton se ky automjet ka kushtuar 136.039 lekë në total (100 euro sipas deklaratës doganore, datë 04.07.2008, dhe shpenzime taksë doganore në shumën 123.856 lekë).

(iv) Gjatë hetimit administrativ, në mënyrë të përmbledhur, subjekti deklaron: (i) *Në pyetësorin standard*: shuma 700.000 lekë e blerjes së automjetit tip “Opel” ka burim krijimi 400.000 lekë nga shitja e automjetit tip “Renault” në vitin 2008, pjesa tjetër me kursime nga pagat dhe të ardhurat e tjera. (ii) *Në prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ*: parashtrimet e subjektit janë të njëjta me sa pretenduar në ankim.

26.2. Trupi gjykues, duke konstatuar se qëndron konstatimi i Komisionit, se shuma prej 400.000 lekësh, e përfituar nga shitja e automjetit tip “Renault Clio”, nuk është deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 dhe nuk është deklaruar as si burim për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa”, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, vlerëson nevojën e analizimit të fakteve dhe rrethanave për të konkluduar nëse qëndron pretendimi i subjektit. *Së pari*, fakti se çmimi i blerjes së automjetit “Renault Clio” është më i ulët se çmimi i shitjes së tij, pothuajse një vit më vonë, nuk e bën *a priori* të dyshuar shumën e përfituar nga shitja, për sa nga akte të kohës dokumentohen veprimet dhe vlerat përkatëse, nuk ka asnjë indicie për fiktivitet të veprimeve dhe nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna për ekzistencë të ndonjë konflikti interesi. Për rrjedhojë, çmimi i shitjes në një vlerë më të lartë se ai i blerjes, në një treg të lirë, që funksionon sipas kërkesë-ofertës, si e dhënë e vetme, për një diferencë relativisht jo shumë të lartë, është i pamjaftueshëm për të ngritur dyshime lidhur me ligjshmërinë e shumës së përfituar nga shitja. *Së dyti*, nga shitja e automjetit tip “Renault Clio” (kontrata mban datën 02.11.2008) dhe blerja e automjetit tip “Opel Corsa” (kontrata mban datën 02.02.2009), përpos se vërehet një periudhë relativisht e shkurtër, rreth 90 ditë kalendarike, mbahet në konsideratë se deklarata e pasurisë e vitit 2008 është dorëzuar prej subjektit në mars të vitit 2009, kur shuma 400.000 lekë ishte përdorur. Për rrjedhojë, nuk përjashtohet mundësia që mosposedimi i shumës në momentin e deklarimit të pasurive dhe interesave për vitin 2008, të ketë passjellë mosdeklarimin si gjendje *cash* të saj. *Së treti*, vitet 2008 dhe 2009 rezultojnë me balancë pozitive, respektivisht në vlerat 1.204.477 lekë dhe 539.177 lekë, sipas analizës financiare të kontrolluar nga NjShL-ja në Kolegj. Për rrjedhojë, subjekti kishte mundësi për ta kursyer dhe përdorur shumën 400.000 lekë për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa” në datën 02.02.2009. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se, me të drejtë, situata është vlerësuar objektivisht nga Komisioni dhe mosdeklarimi në DPV-në e vitit 2008 si gjendje *cash* i shumës 400.000 lekë, e cila është deklaruar në këtë deklaratë si e përfituar nga shitja e automjetit tip “Renault Clio”, është konsideruar si një pasaktësi, që nuk duhet të afektojë vlerësimin e burimeve të pasurisë “Automjet” tip “Opel Corsa”. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji, duke konsideruar faktin që Komisioni e ka pranuar arsyetimin e mësipërm mbi pasaktësinë, korrigjoi analizën financiare të kryer në Komision, duke përllogaritur si shumë të përfituar prej shitjes së automjetit tip “Renault Clio”, në total vlerën e shitjes prej 400.000 lekësh, të cilat konfirmohen edhe nga analiza financiare pozitive e kryer nga Komisioni për vitin 2008, me një mundësi potenciale për disponibilitet të gjendjes *cash* në këtë vlerë. Në mungesë të elementëve të konstatuar për fiktivitet të kontratës së shitjes së automjetit tip “Renault Clio”, trupi gjykues vlerësoi se e gjithë vlera e përfituar nga shitja dhe jo vetëm vlera e blerjes së tij, duhet konsideruar në analizën financiare të blerjes së automjetit “Opel Corsa”.

26.3. Lidhur me pretendimin se në hetimin financiar nuk janë futur veç të ardhurave të subjektit, edhe ato të bashkëshortes dhe nënës së tij, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja deklarojnë si burim kursime/të ardhura nga pagat, të cilat janë përfshirë në analizën financiare. Sa i përket pretendimit për përfshirje të të ardhurave të nënës së subjektit, trupi gjykues e vlerëson pa peshë, për sa edhe me korrigjimet përkatëse në analizën financiare, duke përfshirë shumën nga shitja e automjetit tip “Renault Clio”, në vlerën

400.000 lekë, sërish subjekti rezulton në pamundësi për të justifikuar krijimin e saj me burime financiare të ligjshme në një shumë të konsiderueshme, ndonëse me të reduktuar se ajo që ka konkluduar Komisioni.

26.4. Në përfundim, lidhur me pasurinë “Automjet” tip “Opel Corsa 1.2”, me targë {***}, edhe pasi konsideroi të bazuara pretendimet e subjektit lidhur me përfshirje në analizën financiare të të gjithë shumës së krijuar nga shitja e automjetit tip “Renault Clio”, në vlerën 400.000 lekë, dhe u bënë korrigjimet përkatëse në analizën financiare, sërish subjekti rezultoi në pamundësi për të justifikuar krijimin e saj me burime financiare të ligjshme në shumën prej (-) 218.067 lekësh, një balancë negative më të ulët se ajo e konstatuar prej Komisionit, por që sërish e vendos subjektin edhe për këtë pasuri në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasurinë “Depozitë bankare”, në “American Bank of Investment” ShA

27. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti deklaroi: *Depozitë bankare në “American Bank of Investment” ShA, në shumën 5.400.000 lekë. Llogaria është çelur në datën 13.05.2016. Burimi i depozitës së mësipërme vjen nga kalimi i shumave të lekëve të ndodhur: në depozitë në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, vërtetuar me dokumentin 14.10.2016; në depozitë dhe në bono thesari në BKT, vërtetuar me dokumentin e lëshuar nga banka me datë 14.10.2016; në depozitë me afat dhe në bono thesari në “Raiffeissen Bank”, vërtetuar me dokumentin e lëshuar nga banka me datë 14.10.2016; nga depozitë me interes në Bankën e Kursimeve. Burimi i krijimit: shuma e mësipërme prej 5.400.000 lekësh vjen nga kursimet nga pagat dhe interesat e depozitave në vite, me afat ruajtjeje në Bankën e Kursimeve; depozitë me afat ruajtjeje dhe në depozitë bono thesari në “Raiffeissen Bank”; depozitë me afat në bono thesari në BKT; depozitë me afat në bono thesari në Bankën e Shqipërisë dhe kalimin aktualisht në depozitë ruajtjeje me afat trevjeçar, në ABI Bank. Vlera: 5.400.000 lekë. Pjesë takuese: 50%.*
28. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme në shumën (-) 2.631.804 lekë për krijimin e depozitës bankare në “American Bank of Investment” ShA, situatë që e vendos në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, e cila në vetvete përbën shkak për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Ky konkluzion është bazuar në përfundimet e paraqitura në mënyrë të përmbledhur, si vijon:
- (i) Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e likuiditeteve në bankë, sipas deklarimeve të tij në DPV-në 2003, me burim krijimi kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes, pamundësia e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për shkak të informacionit nga bankat është një situatë jokonkrete.
 - (ii) Lidhur me mundësinë për kursim të shumës 3.100.000 lekë, e cila pavarësisht nga periudhat e krijimit, konkretisht të depozitave pjesore ndër vite, me të ardhura në mënyrë kumulative deri në vitin 2003 (duke e përfshirë edhe vitin 2003), që paraqet mundësitë maksimale për kursim nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij (zbritur shpenzimet jetike dhe ato për krijimin e pasurive ndër vite), nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën (-) 2.596.601 lekë.
 - (iii) Lidhur me situatën e krijuar në vitin 2005, në depozitën në “Raiffeissen Bank”, në datën 21.10.2005, ku subjekti i rivlerësimit depoziton/transferon në llogarinë pranë kësaj banke shumën 751.592 lekë, në një arsyetim logjik të situatës, Komisioni ka vlerësuar ta pranojë veprimin si

transferim e, për pasojë, si gjendje të mbartur nga viti 2004, e cila në vetvete shkon në harmoni edhe me gjendjen e deklaruar dhe llogaritur në vitin 2003, edhe me situatën financiare të rezultuar nga analiza e përgjithshme financiare.

29. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kursimet e tij datojnë përpara vitit 1995 në Bankën e Kursimeve. Në vitin 1982, kur ka qenë student, ka hapur depozitën e parë bankare në degën Tiranë, më pas ka vijuar në degët e kësaj banke në qytetet, ku ai ka punuar dhe vazhdon me veprimet aktuale në “Credins Bank”. Shuma aktuale përmban jo vetëm kursimet nga të ardhurat në vite të familjes së subjektit, por edhe interesat bankare të deklaruar qartë prej tij në DPV-të. Sipas subjektit të rivlerësimit, është në pamundësi të dhënies së informacionit më të plotë të kërkuar, pasi “Raiffeisen Bank”, si vijuese e Bankës së Kursimeve, nuk ka informacion për periudhën para vitit 1995, dhe kalimi i afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumentacionit nga banka, nuk e mundëson dhënien e tij. Likuiditeti në vlerën 3.100.000 lekë nuk duhet të llogaritet sikur është krijuar në vitin 2003, pasi është krijuar nga viti 1982 e në vijim, referuar historikut të dokumenteve bankare të vëna në dispozicion, ndërsa në analizën financiare nuk janë llogaritur likuiditetet e gjendura në bankë nga viti 1995, kur fillojnë dokumentet bankare, deri në vitin 2003, potencoi subjekti.
30. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit, për këtë pasuri, është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të justifikojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e likuiditeteve në bankë, sipas deklarimeve të tij në DPV-në 2003, me burim krijimi kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Në vijim, analiza e detajuar dhe vlerësimi i trupit gjykues.

30.1. Së pari, nga aktet në fashikuj dokumentohet si vijon:

(i) Në DPV-në 2003, në formularin A-5, “Likuiditete”, subjekti deklaroi 1.000.000 lekë në Bankën e Kursimeve Elbasan, me burim krijimi kursime nga pagat. Bashkëshortja e subjektit, S. T., deklaroi depozitë bankare në vlerë 2.100.000 lekë, në Bankën e Kursimeve, me burim krijimi pagesa nga Universiteti “{***}”, paga nga “{***}”, nga D. A. Elbasan; paga shkolla e mesme e përgjithshme “{***}”; projekte dhe kurse private.

(ii) Në procesverbalin e ILDKPKI-së, mbajtur në datën 24.03.2016, lidhur me likuiditetet e depozituara në banka deri në datën 31.12.2014, subjekti deklaroi se burimi nga *ana ime* janë depozita e deklaruar në Bankën e Kursimeve Tiranë, nga kursimet nga puna që nga viti 1986, si prokuror dhe të ardhurat e bashkëshortes nga puna që nga viti 1989 e në vazhdimësi, pra *burimi janë vetëm të ardhurat nga puna jonë shumëvjeçare*.

(iii) Me deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti ka dorëzuar kërkesën drejtuar “Raiffeisen Bank” për informacion, në lidhje me llogaritë rrjedhëse/depozitat për periudhën përpara vitit 2005 dhe përgjigjen e bankës, kthyer me shkresën me nr. {***} prot., datë 30.12.2016, se: *informacioni i ish-Bankës së Kursimeve nuk ka qenë i ruajtur në formë elektronike, për këtë arsye e ka të pamundur të nxjerrë të dhëna për klientët, nëse nuk paraqiten dokumente që vërtetojnë një marrëdhënie të caktuar me bankën. Nëse nga ana juaj disponohen dokumente të tilla, është e nevojshme paraqitja personalisht në një nga degët e RFZ Bank, pasi Banka është e detyruar të ruajë dhe respektojë karakterin sekret të informacionit të klientit*.

(iv) Gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaroi: (i) *Në pyetësorin standard*, se zotëron në emrin e tij dhe të bashkëshortes llogari bankare në vite, duke filluar nga para vitit 1996 dhe deri më sot, të

cilat janë kursimet nga të ardhurat familjare dhe interesat e depozitave bankare në vite (Banka e Kursimeve, “Raiffeisen Bank”, BKT, Banka e Shqipërisë dhe ABI Bank). (ii) Në pyetësorin nr. 2, se depozita bankare në Bankën e Kursimeve, në shumën 2.100.000 lekë, e deklaruar në DPV-në 2003, e ka burimin në të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja nga pagat e marra në “{***}”, Universitetin “{***}” Elbasan, shkollën e mesme “{***}”, Elbasan dhe kurset private. Vlera prej 2.100.000 lekësh është krijuar në harkun kohor para vitit 2003 (1994 – 2003). (iii) Në përgjigje të rezultateve të hetimit, me parashtrime, subjekti bën të njëjtat deklarime si në ankim.

(v) Me parashtrime për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka dorëzuar dy shkresa të “Raiffeisen Bank”, Dega Elbasan: (i) me nr. {***} prot., datë 23.08.2023, në përgjigje të kërkesës së tij për informacion, *lidhur me të dhëna për burimin e krijimit të llogarive përpara vitit 1997, të tij dhe të bashkëshortes*, për të cilën banka informon se nuk e disponojnë këtë informacion; (ii) me nr. {***} prot., datë 21.07.2023, në përgjigje të kërkesës së tij për informacion *lidhur me llogaritë që ka pasur ai dhe bashkëshortja pranë RZF Bank*, për të cilën në përgjigje citohet se ky informacion është kërkuar prej tij edhe në janar të vitit 2021 dhe banka ka kthyer përgjigje, duke dhënë informacionin e kërkuar me shkresën datë 04.02.2021, kopje e së cilës dërgohet bashkëlidhur. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 04.02.2021, të “Raiffeisen Bank”, Dega Elbasan, citohet se, *pas verifikimeve të kryera të arkivin e ish-Bankës së Kursimeve ShA rezultojnë në emër të Mustafa Turkut të dhënat si më poshtë...* Në vijim pasqyrohen të dhëna për tri depozita kursimi dhe gjendjet e tyre që referojnë periudhën 1995 – 2002. Në po këtë shkresë citohet se, *në emër të znj. S. T., nuk rezulton asnjë depozitë sipas verifikimeve në arkivin e ish-Bankës së Kursimeve ShA, Dega Elbasan. Bashkëlidhur ju dërgojmë nxjerrjet e llogarive nga viti 2004, sqarojmë se nuk disponojmë nxjerrje llogarie për vitet e mëparshme që i përkasin ish-Bankës së Kursimeve, pasi banka nuk ka qenë e formatizuar në atë periudhë.*

30.2. Nga analiza e akteve të mësipërme, *së pari*, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje disa konstatime: (i) Mungesë konsistencë në qëndrimet e subjektit, përkundrejt deklarimeve në deklaratat e pasurisë dhe në ILDKPKI, se depozita në ish-Bankën e Kursimeve është krijuar me kursime nga paga si prokuror, nga viti 1986, në parashtrime në Komision, si dhe në ankim pretendon hapjen e depozitës që në vitin 1982, kur ka qenë student. (ii) Përkundrejt deklarimeve se burim krijimi i likuiditeteve në depozitat në Bankën e Kursimeve kanë qenë të ardhurat nga puna, të tij dhe të bashkëshortes, në parashtrime, si edhe në ankim pretendon burim krijimi *kursime të familjes*. (iii) Të ardhurat e bashkëshortes prej organizatës “{***}” dhe kurseve private, të deklaruara ndër burimet e krijimit të depozitës në shumën 2.100.000 lekë, siç do të analizohet gjerësisht në vijim, nuk përmbushin kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke vënë në dyshim ligjshmërinë e shumës së depozituar. *Së dyti*, pretendimi se është në pamundësi të dhënies së informacionit më të plotë, vlerësohet jorelevant. Për krijimin e gjendjes së likuiditeteve në depozitat bankare të deklaruara në DPV-në 2003, subjekti ka dështuar të provojë mjaftueshmërinë e të ardhurave financiare të ligjshme në përputhje me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ndërkohë që pamundësia e pretenduar i referohet përgjigjes së bankës për mungesë informacioni, *lidhur me burimin e krijimit të llogarive përpara vitit 1997*, por që nuk përfaqëson informacionin, i cili provon ligjshmërinë e burimit. *Së treti*, të dhënat nga dokumentacioni bankar i administruar, ndonëse periudhat e gjendjes së depozitave janë të segmentuara³², vijnë mjaftueshmërisht në harmoni me vlerën e deklaruar në DPV-në 2003, prej

³² Depozitë kursimi me nr. {***}, gjendja në datën 29.01.1996; datë 30.01.1997; datë 30.01.1999 dhe datë 30.01.2001. Depozitë kursimi me nr. {***}, gjendja në datën 02.03.1995; datë 25.09.1998; datë 30.03.2000; datë 30.03.2001 dhe

3.100.000 lekësh, për rrjedhojë, subjekti duhet të provonte mundësitë financiare për krijimin e këtyre likuiditeteve, në përputhje me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. *Së katërti*, nga kontrolli i analizës financiare kumulative për periudhën 1993 – 2002, rezulton se subjekti nuk kishte mundësi të krijonte kursime deri në vitin 2002, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se likuiditetet në bankë janë krijuar nga viti 1982 e në vijim, jo vetëm mbetet deklarativ, por edhe nëse këto likuiditete në banka do të ishin krijuar që në këtë periudhë, ato nuk do të mbuloreshin dot me burime financiare të ligjshme, për shkak se me të ardhurat e krijuara, subjekti ka investuar në krijimin e pasurive të tjera të paluajtshme dhe ka përballuar shpenzimet e jetesës.

30.3. Në përfundim, nga kontrolli që iu bë analizës financiare të kryer prej Komisionit, në funksion të kontrollit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, rezultoi e drejtë metodologjia e përdorur dhe shtrirja e analizës deri në fund të vitit 2003, kur sipas deklarimeve të vetë subjektit në DPV-në këtij viti, daton në mënyrë përfundimtare krijimi i shumës prej 3.100.000 lekësh, të cilat janë përdorur më pas për krijimin e depozitës objekt kontrolli. Në analizën financiare të periudhës 1993 – 2002, duke përllogaritur në vitin 1998 vlerën 500.000 lekë, për apartamentin 3+1, në vitin 2000 vlerën prej 299.820 lekë, për shtesën me sip.14.4 m² dhe 700.000 lekë, për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”; duke mos përllogaritur të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi në organizatën “{***}”, për të cilat subjekti nuk provoi pagesën e detyrimeve tatimore, si dhe shpenzimet e jetesës për vitin 2000, në masën 30% të të ardhurave të subjektit, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të krijonte kursime deri në vitin 2002. Si rrjedhojë, në analizën financiare për krijimin e depozitave në vlerën 3.100.000 lekë, u përllogariten vetëm të ardhurat e vitit 2003, në një version garantist për subjektin, ndonëse duket se devijon nga deklaratimet e tij për kohën e krijimit të tyre, nga ku rezultoi se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën (-) 2.596.601 lekë, për të krijuar vlerën likuiditet të deklaruar prej tij në masën 3.100.000 lekë, deri në vitin 2003.

30.4. Lidhur me depozitim *cash* në llogarinë bankare në ABI Bank, të kryer nga subjekti në datën 13.05.2016, në shumën 900.000 lekë, e cila ka shërbyer si një prej burimeve për çeljen e depozitës në shumën 5.400.000 lekë³³, nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare për periudhën 01.01.2016 – 13.05.2016, rezultoi se për këtë depozitim, përkundrejt vlerës të përllogaritur nga Komisioni prej (-) 35.203 lekësh³⁴, subjekti nuk kishte mundësi financiare në vlerën (-) 205.202 lekë. Në zbatim të parimit *no refertatio in peius*, trupi gjykues vlerësoi të konsiderojë balancën negative (-) 35.203 lekë, sipas shifrës së konkluduar prej Komisionit.

30.5. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se balanca negative e konstatuar në krijimin e likuiditetit prej 3.100.000 lekësh deri në vitin 2003, krahas asaj të konstatuar në vitin 2016, për depozitim në *cash* të shumës prej 900.000 lekësh, e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 31.** Në mbështetje e vlerësim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se balancat negative të konstatuara për pasuritë e përshkruara më lart, në vlerë totale prej (-) 3.732.498

20.12.2001. Depozitë kursimi me nr. {***}, gjendja në datën 07.02.1995; datë 07.03.1996; datë 30.12.1999 dhe datë 23.11.2002.

³³ Në llogarinë bankare të çelur në ABI Bank, në datën 13.05.2016, është transferuar shuma 4.500.000 lekë nga BKT-ja dhe, po në këtë datë, prej subjektit është depozituar në *cash* shuma prej 900.000 lekësh.

³⁴ Komisioni në analizën e tij financiare, për periudhën 01.01.2016 - 13.05.2016, ka përllogaritur shpenzimet e jetesës për 2 persona, ndërkohë që familja e subjektit përbëhet nga 4 persona (subjekti, bashkëshortja dhe 2 fëmijët).

lekësh³⁵, e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

D. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {}, viti 2011³⁶***

32. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, viti 2011, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me kallëzues shtetasin A. B. Prokurori i çështjes/subjekti i rivlerësimit, pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore, ka arritur në konkluzionin se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi, i ndodhur në arkivin e ZVRPP-së Elbasan, lëshuar në emër të kallëzuesit, nuk është i falsifikuar, ndryshe nga sa pretendohet prej tij. Bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “a” e K. Pr. Penale, në datën 06.06.2012, është vendosur pushimi i procedimit penal.
33. Komisioni e ka gjetur të gabuar vendimmarrjen e subjektit lidhur me këtë procedimin penal, sa i përket njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shmangur kryerjen e disa veprimeve hetimore të konsideruara si të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të çështjes, duke evidentuar problematika të rëndësishme në ushtrimin e ndjekjes penale në çështjen në fjalë, e cila vlerësohet se ka mbetur jashtë kontrollit gjyqësor, të paktën për shkak të mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Mbi bazën e këtyre përfundimeve, Komisioni ka konkluduar se, *ndonëse gjenden elemente që tregojnë për ekzistencën e një vlerësimi me mangësi të çështjes, në kuadër të aftësive profesionale, nuk i vlerëson vetëm këto mangësi të vlefshme për të konkluduar në lidhje me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, duke krijuar premisa për një vlerësim të tyre sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*
34. Subjekti i rivlerësimit pretendon se hetimi ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm, dhe se vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2011, me kallëzues shtetasin A. B., ka qenë i bazuar në ligj. Pushimi i çështjes është bërë me argumentin se fakti nuk ekziston, në bazë të nenit 328, pika 1, germa “a” të K. Pr. Penale. Sipas subjektit, kallëzuesi pretendonte për falsifikim të AMTP-së në emër të tij, që gjendej në ZVRPP-në Elbasan. Pas hetimit rezultoi se AMTP-ja që gjendej në ZVRPP-në Elbasan ishte në përputhje të plotë me formularin nr. 6, që shërbente si origjinë dokumentare për pronën. Nga akt-ekspertimi topografik i datës 20.04.2012 ka rezultuar se AMTP-ja që gjendej në ZVRPP-në Elbasan ishte në përputhje me pronën në terren. Duke qenë se falsifikimi i AMTP-së që gjendej në ZVRPP-në Elbasan nuk ekzistonte, sikundër pretendonte kallëzuesi, pushimi i çështjes është bërë me argumentin që fakti nuk ekziston. Kopjet e pavërtetuara të shkresave janë marrë me qëllim orientimin e hetimit, vendimmarrja nuk është bazuar në këto shkresa të pavërtetuara, potencoi subjekti.

³⁵ Pas kontrollit në Kolegj të analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit për krijimin e pasurive ka pamundësi financiare me burime të ligjshme, si vijon: (i) shtëpi banimi apartament 3 + 1 + shtesa, në vitin 2000, në vlerën prej (-) 529.053 lekësh; (ii) automjeti “Mercedes Benz”, në vlerën prej (-) 353.574 lekësh, në vitin 2000; (iii) për krijimin e depozitës bankare në shumën prej 5.400.000 lekësh në ABI Bank: lidhur me depozitat bankare të vitit 2003, në vlerën prej 3.100.000 lekësh, në shumën prej (-) 2.596.601 lekësh; dhe lidhur me depozitimin në cash të shumës prej 900.000 lekë, në datën e krijimit të depozitës 13.05.2016, në shumën prej (-) 35.203 lekësh; (iv) për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa”, në vitin 2009, në shumën prej (-) 218.067 lekësh.

³⁶ Nga verifikimi i të dhënave nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar disa kallëzime penale të paraqitura nga shtetasi A. B., për të cilat është vendosur mosfillimi, si edhe disa ankesa të këtij shtetasi të paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme.

35. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Trupi gjykues i gjen të pabazuara dhe të pajustificuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit lidhur me këtë çështje. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

35.1. Nga aktet në fashikull rezulton e dokumentuar si vijon:

(i) Vendimi i prokurorit/subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2011, është ankimuar prej kallëzuesit A. B., *si i padrejtë e i paligjshëm për shkak se prokurori nuk ka kryer ekspertimin grafik të shkrimeve*, ndërsa prej prokurorit është kërkuar rrëzimi i ankimit, me arsyetimin se pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë.

(ii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 20.07.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2011, të marrë nga prokurori/subjekti në datën 06.06.2012, dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve nga prokuroria. Në vendimin e gjykatës, ndër të tjera, konstatohet:

- Në kallëzimin e marrë ankuesit nuk janë përcaktuar saktësisht elementet thelbësore të faktit të paligjshëm që kallëzohet, të cilat do të përbënin rrethana të faktit dhe burime të provave, pa të cilat nuk mund të kryhej asnjë veprim në funksion të dhënies përgjigje ndaj kallëzimit.
- Në kundërshtim me dispozitat e K. Pr. Penale, nenin 191, janë marrë të përfshira në fashikull kopje të pavërtetuara shkresash, ankuesi mund të orientohej të paraqiste dokumentet origjinale ose kopje të vërtetuara, por nuk duhej t'i merreshin e administroheshin në hetim fotokopje të pavërtetuara shkresash.
- Nga aktet e marra në hetimin paraprak ka dyshim të bazuar se AMTP-ja e lëshuar për ankuesin është e falsifikuar, shkak për të cilin pretendimi i prokurorit, për mungesë të qartë të faktit, është i pabazuar. Në rihetim, organi i procedues duhet të sekuestrojë në ZVRPP origjinalin e AMTP-së së ankuesit, të ripyese në cilësinë e dëshmitarit disa shtetas dhe anëtarët e ish-Komisionit, nëse e kanë nënshkruar këtë akt, e më tej të kryejë akt-ekspertimin grafik për AMTP-në. Nëse gjendet akti origjinal që i është dhënë ankuesit nga Komisioni, të bëhet krahasimi me AMTP-në e gjendur në ZVRPP-në Elbasan dhe, nëse është e nevojshme, edhe ky akt t'i nënshtrohet akt-ekspertimit. Në varësi të rezultateve të hetimit mund të kryhen edhe veprime të tjera hetimore, e më tej të dilet në konkluzion bindës për ekzistencën e faktit.

(iii) Në zbatim të vendimit të gjykatës, Prokuroria Elbasan ka riçelur hetimet, çështja është trajtuar nga prokurore A. XH., e cila ka konkluduar se AMTP-ja me nr. {***}, në emër të shtetasit A. B., pas ekspertimit teknik-grafik ka rezultuar e falsifikuar dhe se plotësoheshin elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Bazuar në nenin 66/b të Kodit Penal dhe 328/1/d të K. Pr. Penale është vendosur pushimi i procedimit penal për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në vendimin për pushimin e procedimit, ndër të tjera, pasqyrohet: *[...] AMTP për shtetasin A. H. B., nga fshati {***}, me nr. {***}, i shënuar me laps (përbri nr. {***}), dt. 20-XII-91”, i sekuestruar në origjinal pranë ZVRPP Elbasan, duhet të deklarohet i falsifikuar. Për këtë arsye, ky dokument, së bashku me një kopje të aktit të ekspertimit teknik-grafik, duhet t'i dërgohet ZVRPP Elbasan, e cila duhet të evidentojë faktin se ky dokument është i falsifikuar. [...]*

35.2. Lidhur me këtë çështje, trupi gjykues çmon të evidentojë disa konstatime. *Së pari*, për barrën e provës,³⁷ subjekti ka prapësuar me shpjegimin: [...] *Lidhur me çështjen që lidhet me shtetasin A. B., bashkëngjitur po ju dërgojmë akte që kanë të bëjnë me të [...]*, dhe ka paraqitur dokumentin “Diskutim përfundimtar”, të datës 10.06.2015. Me këtë qëndrim lidhur me barrën e provës, modalitetet dhe formën e përmbysjes së saj, *a prima vista*, duket se subjekti ka zgjedhur të ushtrojë në mënyrë të kufizuar, sipas vullnetit të tij, të drejtën për t’u mbrojtur e përmbysur barrën e provës. Përpos kësaj, zgjedhja për të prapësuar me të njëjtin dokument/argumente si në gjykatë, e cila argumentet e tij në mbrojtje të vendimmarrjes për pushimin e procedimit penal i ka gjetur të pabazuara, duket në mungesë koherence e tentativë për të shmangur përgjegjësinë. *Së dyti*, aktet e tjera të paraqitura prej subjektit në përgjigje të barrës së provës, nuk kanë asnjë relevancë për t’i dhënë përgjigje gjetjeve të Komisionit, përderisa atyre iu mungojnë elementet e formës (pa firmë të titullarit, pa vulë të institucionit) dhe duken si një përpjekje e subjektit për të ndikuar te Komisioni, me synimin për të krijuar bindjen për problematika të shtetasit A. B., në raport me ligjin penal dhe vetë organin e akuzës, por pa dhënë shpjegimet e duhura për vetë veprimtarinë e tij procedurale.³⁸ *Së treti*, subjekti, që aktualisht pretendon se vendimi i tij ka qenë i bazuar në prova dhe në ligj, nuk jep asnjë shpjegim përse nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës, që ka prishur vendimin e tij për pushimin e procedimit penal, mjet i parashikuar nga ligji dhe që mbështetet në interpretimin dhe logjikën e magjistratit. Mosushtrimi i ankimit, nuk përjashton mundësinë që vetë subjekti të ketë gjetur të drejtë vendimin e gjykatës.

35.3. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit se vendimi i tij për pushimin e procedimit penal nr. {***} është i bazuar në prova dhe në ligj, mbeten të pabazuara dhe të pambështetura, aq më tepër në kontekstin e disponimit të vendimit gjyqësor, por edhe vendimit të ndryshëm të një tjetër prokurori, që pasi ka kryer hetime të plota, sipas urdhërimeve të gjykatës, ka vendosur se dokumenti për të cilin shtetasi A. B., kishte bërë kallëzim penal, ishte i falsifikuar. Përpos vendimmarrjes së gabuar sa i

³⁷ Komisioni, në zbatim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, duket se: (i) konkluzioni i arritur nga subjekti/prokurori për pushimin e procedimit penal është i pabazuar në aktet që ndodhen në dosje dhe pasojë e një hetimi jo të plotë e të gjithanshëm; (ii) konkluzioni është nxjerrë sipas një akt-ekspertimi, rezultatet e të cilit janë bazuar në vetë aktin që pretendohet i pavërtetë; (iii) sipas procesverbalit “Për marrjen e dokumenteve”, datë 27.09.2011, janë administruar kopje të pavërtetuara shkresash në kundërshtim me nenin 191 të K. Pr. Penale.

³⁸ Subjekti ka paraqitur:

- Shkresë/përgjigje e Prokurorisë Elbasan drejtuar Ministrisë së Drejtësisë/Drejtorisë së Inspektimit për Prokurorinë, pa ekstremitete (nr. prot. e datë, shtypshkruar vetëm viti 2013), e panënshkruar nga Drejtuesi i Prokurorisë G. O. Në përmbajtje jepet informacion lidhur me: (i) vendimin e pushimit të procedimit penal nr. {***}, marrë në bazë të nenit 328, pika 1/a, të K. Pr. Penale, pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore, shtetasi A. B., ka bërë ankim në gjykatë dhe çështja është në shqyrtim; (ii) vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. B., për veprën penale “Pushtimi i tokës”, vendim i ankimit në gjykatë, e cila me vendimin nr. {***} ka vendosur pushimin e çështjes; (iii) regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. B., për veprat penale të “Mashtrimit” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”, ku në përfundim të hetimit, në datën 09.09.2013, çështja është dërguar në gjykatë me të pandehur A. B., i akuzuar për veprat penale “Kallëzim i rremë” dhe “Deklarime të rreme përpara prokurorit”, çështje ende në gjykim.

- Shkresë/përgjigje e Prokurorisë Elbasan drejtuar Prokurorisë, pa nr. prot., datë 18.05.2015,³⁸ dhe e panënshkruar nga Drejtuesi i Prokurorisë E. B. Në përmbajtje pasqyrohet se shtetasi A. B., është sqaruar disa herë shkresërisht nga Prokuroria Elbasan se, për sa prej tij është bërë ankim në gjykatë për vendimin e pushimit të procedimit penal nr. {***} dhe çështja është në gjykim, është e drejtë e tij të paraqesë përpara gjykatës çdo pretendim.

- Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nr. {***}, datë 25.07.2014, me të cilin për të pandehurin A. B., është vendosur pushimi i çështjes penale “Deklarimi i rremë përpara prokurorit”, vlerësuar si veprë që amnistohet, dhe deklarimin fajtor të tij për kryerjen e veprës penale “Kallëzim i rremë” dhe dënimin e tij me një vit burg.

përket njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, trupi gjykues vlerëson se shmangia e veprimeve hetimore të konsideruara të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të çështjes, evidenton problematika të rëndësishme në ushtrimin e ndjekjes penale në çështjen në fjalë, e cila, për shkak të mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka mbetur jashtë kontrollit gjyqësor. Për rrjedhojë, trupi gjykues gjen të drejtë e të bazuar konkluzionin e Komisionit që në këtë çështje, elementet që tregojnë ekzistencën e vlerësimit me mangësi të saj në kuadër të aftësive profesionale, krijojnë premisa për vlerësimin e tyre sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me çështjen e të dënuarit V. Y.

36. Për të verifikuar të dhënat sipas disa *indicieve* nga burime të hapura³⁹, Komisioni ka kërkuar dhe administruar informacion dhe dokumentacion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe prokuroria pranë kësaj gjykate. Nga dokumentacioni ka rezultuar se procesi lidhur me ekzekutimin e vendimit për shtetasin V. Y., është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit. Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit në raport me informacionin e përcjellë nga institucionet dhe atë të marrë përmes *denoncimeve të hapura*, Komisioni ka konkluduar se veprimet e subjektit, të paktën në këtë rast dhe në rastin e procedimit penal nr. {***}, krijojnë kushte për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në mënyrë të përmblodhur, përfundimet e Komisionit janë si vijon:

(i) Nga analiza e qëndrimeve të organit të akuzës lidhur me këtë çështje, në vetvete shumë sensitive, rezulton se, së paku, subjekti i rivlerësimit ka reflektuar një sjellje profesionale sipërfaqësore dhe jo në përmbushje të detyrës, duke pranuar të drejtat e kërkuarit (të dënuarit) të paktën nëpërmjet mosveprimit të organit të akuzës.

(ii) Tërësia e të gjitha sjelljeve pasive të organit të akuzës ndaj kësaj çështjeje dhe në fund ankimi ndaj një vendimi gjykate, për të cilin vetë organi i akuzës është shprehur dakord gjatë gjykimit, i cili, në vetvete, mbetet i papërligjur në ndonjë rrethanë, prodhon gjithsesi një perceptim negativ të publikut, matur nga syri i një vëzhguesi të zakonshëm, në drejtim të funksionimit të organit të akuzës. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, se kjo është një praktikë e ndjekur në shumë raste nga organi i akuzës, nuk mundën të justifikojnë thelbin e zgjidhjes së çështjes, e cila, e vlerësuar në tërësinë e saj, ka cenuar thelbin e veprimtarisë së organit të akuzës, duke e shndërruar atë në një proces abuziv.

(iii) Në konkluzion nga aktet e analizuara, nga një vëzhgim i kronologjisë së veprimeve e mosveprimeve të kryera prej subjektit, konstatohen sjellje sipërfaqësore, të cilat duket se, përpos të tjerave, kanë ndikuar në zgjidhjen e çështjes sipas kërkesave të të dënuarit, duke krijuar një perceptim publik që cenon imazhin e organit të akuzës dhe që bie ndesh me vlerat që duhet të përçojë integriteti i magjistratit e që, për pasojë, krijon kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe kualifikohet sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

37. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për cenim të besimit të publikut te drejtësia, është i padrejtë jo vetëm për shkak të mosrespektimit të normave procedurale që garantojnë procesin e rregullt, por edhe për vetë thelbin e tij. Me pretendimet se në qëndrimet e tij nuk ka asgjë konfuze, se ka përfaqësuar organin e akuzës në mënyrë dinjitoze dhe ka mbrojtur interesin publik në

³⁹ <https://www.cna.al/2021/02/13/u-pendua-per-lirimin-e-dajes-se-padrinos-prokurori-ne-listen-e-zeze-te-pasurive-2>

mënyrën më të mirë të mundshme dhe në përputhje me parashikimet e K. Pr. Penale, subjekti, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohet si vijon:

(i) Për sa kohë nuk ekzistonte asnjë lloj dyshimi, pasi aktet sillen para gjykatës nga personat përgjegjës të IEVP-së Peqin, në seancë gjyqësore ka mbajtur qëndrim që kërkesa duhet pranuar si e bazuar në prova dhe në ligj. Duke qenë prokuror në seksionin e ekzekutimeve, brenda afatit ligjor të ankimit, i është vënë në dispozicion vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, me objekt gjykimi po kërkesën për njohjen e ditëve të punës për V. Y. Brenda afatit ka bërë ankim, këtë fakt e parashtrohet edhe përmbajtja e ankimit.

(ii) Prokurori i Seksionit të Ekzekutimeve nuk mund të ushtrojë ankim ndaj vendimeve që vijnë në këtë seksion, me qëllim për t'u vënë në ekzekutim. Ndaj këtyre vendimeve bën ankim vetëm prokurori që ka përfaqësuar prokurorinë në gjykim, prokurori i ekzekutimeve ka të drejtë të bëjë ankim vetëm ndaj vendimeve të gjykatës ku ai ka përfaqësuar organin e akuzës. Nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit për vendimin gjyqësor, ku nuk ka qenë përfaqësues i akuzës, është veprim në përputhje me veprimet e Sektorit të Ekzekutimit.

(iii) Nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit nuk shpreh dakordësinë me vendimin, por prokurori është i detyruar ta ekzekutojë atë, edhe sikur të mos jetë prokuror i çështjes. Qëndrimet janë koherente dhe të qarta, është shprehur për rrëzimin e kërtimeve kur kanë qenë të pabazuara në ligj.

(iv) Nuk ka munguar në seanca gjyqësore, por janë seanca gjyqësore që janë zhvilluar pa u njoftuar prokuroria, për rrjedhojë nuk ka pasur asnjëherë miratim në heshtje, por nuk ka pasur dijeni për gjykimin.

(v) Në gjykimet ku ka marrë pjesë, e ka shprehur qartë mendimin. Ka ushtruar ankim në rastin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, edhe pse në gjykim është shprehur dakord, bazuar në fakte për të cilat ka marrë dijeni pas dhënies së vendimit/dalje të provës së re.

(vi) Është e padrejtë dhe rënduese në mënyrë joproporcionale të ngarkosh me përgjegjësinë e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” një subjekt rivlerësimi, që gjendet në rrethanat sikundër është rivlerësuar ai për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

38. Lidhur me çështjen e të dënuarit V. Y., trupi gjykues i vlerëson të drejta konkluzionet e Komisionit, lidhur me sjelljen procedurale të subjektit në trajtimin e kërkesave të këtij të dënuari gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka anashkaluar parashikimin urdhërues të nenit 128, pika 1, shkronja “b” të K. Pr. Penale në ekzekutimin e vendimit gjyqësor me nr. {***}, datë 09.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si pasojë e një procesi gjyqësor të zhvilluar në mungesë së organit të akuzës dhe në kundërshtim me detyrimin që përcakton neni 471 i Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka treguar jo vetëm mungesë koherence në qëndrimin që ka mbajtur në gjykimin e kërkesës së këtij të dënuari, për konvertimin e ditëve të punës gjatë kryerjes së burgimit me ditë burgimi, të gjykuar me vendimin nr. {***}, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, por edhe ka treguar mungesë të theksuar të njohurive të ligjit lidhur me thelbin e kërkesës, duke pranuar për zbatim e identifikim të bazës ligjore ku mbështetej ajo, një kuadër ligjor të shfuqizuar herët në kohë, dhe shmangur në këtë mënyrë identifikimin dhe zbatimin e ligjit të duhur për zgjidhjen e rastit. Në vijim, analiza dhe vlerësimi i trupit gjykues.

38.1. Nga aktet në fashikull rezulton e dokumentuar si vijon:

(i) I dënuari V. Y., ka vuajtur dënimin në seksionin e sigurisë së lartë pranë IEVP-së Peqin për dy vrasje⁴⁰. Lidhur me ekzekutimin e vendimit penal evidentohet:

(ii) *Vendimi nr. {***}, datë 09.07.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*, ka trajtuar kërkesën “Për përfitimin e uljes së dënimit”, me kërkesues V. Y., me të cilin është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës, duke e ulur dënimin në total me 360 ditë burgim nga vuajtja e dënimit të mbetur, në aplikim të nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, i ndryshuar. Në përmbajtje të vendimit pasqyrohet se, referuar dinamikës së vuajtjes së dënimit, të sjellë nga IEVP-ja Peqin, e datës 08.07.2019, i dënuari ka vuajtur 22 vjet e 10 muaj e 4 ditë dhe i kanë mbetur për të vuajtur 2 vjet e 1 muaj e 26 ditë burgim, dhe ka kërkuar t’i ulet dënimi me 45 ditë burgim për çdo vit, duke filluar nga viti 2001, kur ka fituar statusin e të dënuarit, sipas të drejtës që i jep ligji për të dënuarit. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 24.07.2019, pa u ankimuar, dhe në përmbajtje të tij konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka marrë pjesë në gjykim dhe as nuk pasqyrohet si palë. Në datën 24.09.2019, prokurori Mustafa Turku ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal nr. {***}, datë 09.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

(iii) *Vendimi nr. {***}, datë 10.07.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*, ka trajtuar kërkesën “Për uljen 1 vit burgim nga dënimi i mbetur si pasojë e ligjit për amnistinë”, me kërkesues V. Y., me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës dhe përjashtimi nga vuajtja e dënimit me 1 vit burgim nga pjesa e pavuajtur e dënimit, në bazë të ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë pjesë në gjykim, përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës së të dënuarit. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, në datën 25.07.2019.

(iv) *Vendimi nr. {***}, datë 20.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*, ka trajtuar kërkesën e të dënuarit V. Y., “Për llogaritje të ditëve të burgimit”, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkesit sipas objektit, për shkak të heqjes dorë të kërkesit. Prokuroria

⁴⁰ - Shtetasi V. Y. është arrestuar në datën 29.06.1999, për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, e kryer në bashkëpunim me paramendim, dhe “Armëmbajtje pa leje”, sipas neneve 25, 78 dhe 278 të K. Penal; është dënuar me burgim të përjetshëm me vendimin nr. {***}, datë 20.04.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 15.03.2001, të Gjykatës së Apelit Durrës, që është rekursuar në Gjykatën e Lartë, që me vendimin nr. {***} ka vendosur mospranimin e rekursit.

- I dënuari V. Y., ka bërë kërkesë për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 28.10.2015, ka vendosur prishjen e të tria vendimeve të sipërcituara dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, por me tjetër trup gjykues.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 23.06.2017, ka vendosur të deklarojë fajtor shtetasin V. Y., duke e dënuar me burgim të përjetshëm. Pas ankimit nga i dënuari, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 31.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me ndryshimin duke e dënuar V. Y., me 25 vite burgim.

- V. Y., për një ngjarje të ndodhur në vitin 1996 në Itali, është dënuar gjithashtu nga Gjykata e Romës për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, në bashkëpunim mbetur në tentativë, me 24 vite burgim, vendim i njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. {***}, datë 21.12.2016, duke i caktuar dënim me 23 vite burgim, një vit i konsideruar i ulur nga amnistia sipas ligjit nr. 22/2014; ndërsa Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. {***}, datë 14.04.2017, ka vendosur të caktojë dënimin me 24 vite burgim.

- Me vendimin nr. {***}, datë 31.05.2019, datë 31.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është bërë bashkimi i dy vendimeve dhe është vendosur përfundimisht që V. Y., të dënohet me 25 vite burgim.

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë pjesë në gjykim, përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku. Në vendim pasqyrohet se, në fillim të shqyrtimit gjyqësor, nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi u kërkua heqja dorë nga kërkesa. Ndodhur përpara këtij fakti, nga ana e prokurorit u kërkua të vendoset mospranimi i kërkesës së të dënuarit. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, në datën 05.12.2019.

(v) *Vendimi nr. {***}, datë 25.11.2019*, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka trajtuar kërkesën “Për shuarje dënimi”, me kërkues V. Y., me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës për shkak të heqjes dorë nga kërkuesi. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë dhënies së vendimit, që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 06.01.2020.

(vi) *Vendimi nr. {***}, datë 27.11.2019*, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka trajtuar kërkesën “Për njohje të ditëve të punës (konvertuar në ditë burgimi)”, me kërkues V. Y., vendim me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës, njohja e ditëve të punës e konvertuar në 5 muaj e 16 ditë burgim: “Urdhërohet Sekretaria të njoftojë IEVP-në Peqin. Një kopje e vendimit t’i dërgohet për ekzekutim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Në vendim, i cili është bazuar në nenet 470, 471 e vijues të K. Pr. Penale, ligjin nr. 8328/1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; Dekretin nr. 7298, datë 08.04.1989; pasqyrohet se sipas akteve të IEVP-së Peqin provohet punësimi i të dënuarit në vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011 (muajt përkatës) dhe ditët respektive të përfituara, *me punë të kryer*. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është përfaqësuar nga prokurori Mustafa Turku, qëndrimi i të cilit pasqyrohet në vendim si vijon: “...nga ana e Prokurorit u kërkua pranimi i kërkesës, pasi nga provat shkresore të paraqitura nga institucioni i vuajtjes së dënimit rezulton se është e bazuar në prova e në ligj”. Po më datë 27.11.2019, prokurori/subjekti ka bërë ankim kundër vendimit të sipërcituar, ku ndër të tjera parashtroi: [...] *nuk është në kompetencën tonë ekzekutimi i vendimit nr. {***}, datë 27.11.2019, për vetë natyrën e këtij vendimi. Është IEVP Peqin organi, i cili duhet të merret me ekzekutimin e tij dhe të bëjë përllogaritjen e duhur për të dënuarin... në kushtet kur kemi dy vendimmarrje nga gjykatat në lidhje me ditët e punës për efekt të uljes së dënimit të dhënë ndaj këtij të dënuari, Gjykata e Apelit Durrës, që i nuk njeh këto ditë pune, dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, objekt ankimi, që i njeh këto ditë pune, në bazë të nenit 408 të K. Pr. Penale, kërkoj ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 27.11.2019. [...]*

(vii) Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 30.07.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vendimi nr. {***}, datë 30.07.2020, ka marrë formë të prerë në datën 30.07.2020. Gjykata e Apelit Durrës, ndër të tjera, ka arsyetuar: [...] *prokurori, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur në shkallë të parë, ku është shprehur për pranimin e kërkesës, siç edhe ka disponuar kjo gjykatë, ka ushtruar ankim duke pretenduar se vendimi i dhënë nga gjykata nuk është pjesë e atyre vendimeve që ekzekutohen menjëherë, si i tillë ky vendim nuk mund të ekzekutohet nga ky organ, për sa kohë vetë ligji nuk është shprehur në mënyrë të saktë për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të kësaj natyre dhe është IEVP organi që duhet të merret me ekzekutimin... Gjykata e Shkallës së Parë, me të drejtë, ka disponuar që një kopje e vendimit t’i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në rastin konkret për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimit (referuar parashikimeve të nenit 24 dhe 25 të K. Pr. Penale), ndërsa efektet e zbatueshmërisë së këtij vendimi duhet të vlerësohen nga prokurori në raport me parashikimet ligjore për ekzekutimin e vendimeve penale të kësaj natyre... jo vetëm nuk rezulton ndonjë konflikt mes prokurorisë dhe IEVP-së për kohën dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit penal, por këto pretendime nuk mund të jenë objekt i këtij gjykimi ...duhet të vlerësohen dhe të gjejnë zbatim rregullimet e*

dispozitave përkatëse procedurale dhe ligjore për ekzekutimin e vendimeve penale... nga ana e prokurorit u pretendua rishtazi, se dokumentacioni për punësimin e të dënuarit ishte i paqartë, me dyshime për parregullsi dhe të dhëna të pasqyruara në to... pavarësisht këtij pretendimi të ngritur në gjykim, prokurori nuk arriti të argumentojë dhe provojë se ku qëndrojnë paqartësitë, dyshimet apo parregullsitë e pretenduara ...[...]. Më datë 02.10.2020, prokurori/subjekti ka nxjerrë urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. 1212, datë 27.11.2019.

(viii) *Vendimi nr. {***}, datë 25.02.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka trajtuar kërkesën e të dënuarit, V. Y., “Ulje mase dënimi”, ku gjykata ka konstatuar se i dënuari, me urdhrin nr. {***} prot., datë 27.12.2019, është liruar nga burgu dhe për këtë shkak ka vendosur deklarinimin si të papranueshëm të gjykimit të çështjes. Nga vendimi, i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, në datën 11.03.2020, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka marrë pjesë në gjykim.*

38.2. Në seancë dëgjimore, subjekti vetë, si edhe përmes avokatit të tij, deklaroi⁴¹:

- [...] *Për sa i takon rastit të V. Y., ju vë në dispozicion vendimet e Gjykatës së Elbasanit për uljet e dënimeve me kërkesë të të dënuarve ...ku prej vitesh ne nuk jemi pjesë e proceseve gjyqësore... Kjo është arsyeja pse unë nuk kam marrë pjesë në këto gjyqe, nuk lidhet me mosdashjen time, por lidhet me faktin se është një realitet i pranuar nga gjykata dhe nga ligji për ekzekutimet e vendimeve, të cilat ne nuk marrin pjesë. Marrim pjesë në rastet e tjera. Sa i takon rastit që kam qenë dakord për ditët e punës së të dënuarit, parimisht kam qenë dakord, sepse nuk mund të vë në dyshim dokumentacionin nga IEVP-ja, i përpiluar nga personat përkatës me vulë e me firmë... pas përfundimit të gjyqit jam vënë në dijeni se ka pas një problem të kësaj natyre, gjë për të cilën u detyrova të bëj ankim, pastaj se nuk isha i qartë në vetvete. [...]*

- [...] *nëse ankohen apo jo vendimet e uljes së dënimit ...nuk ka të drejtë prokurori i ekzekutimeve të bëjë ankim në çështje për të cilat nuk është palë. Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve këtë përgjegjësi ia ka ngarkuar IEVP-së. ...Ka një komision të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i cili jep mendim me shkrim që dorëzohet në gjykatë. Dhe duke qenë se gjykata është garantimi i ligjit, prokurorit nuk i jepet një mundësi e tillë që ta ankimojë një vendim kur nuk është palë. [...]*

38.3. Sa më sipër konstatohet se në ankim subjekti pretendon për mosnjohim nga gjykata për seancat gjyqësore, ku evidentohet mungesa e përfaqësimit të organit të akuzës/prokurorit, qëndrim i ndryshëm nga parashtrimet në Komision, ku ka pretenduar për mospjesëmarrje në gjykime me objekt uljen e dënimeve penale, si një realitet të pranuar nga gjykata. Në vështirësi të nenit 471 të K. Pr. Penale, që përcakton: “Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve”⁴² dhe në pikën 2, “Kur kërkesa është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkesë të rrëzuar, të mbështetur mbi të njëjtat shkaqe, gjykata, pasi dëgjon prokurorin, e deklaron atë të papranueshme me vendim”, evidentohet rëndësia dhe dosmosdoshmëria e pjesëmarrjes së prokurorit në procedim, pa lënë hapësira për realitete, siç pretendon subjekti. Referuar parashikimeve të sipërcituara, lexuar së bashku me nenin 128 të K. Pr. Penale, që parashikon se mosrespektimi i dispozitës për të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim shkakton pavlefshmërinë absolute të akteve procedurale; si dhe me nenin 428 të K. Pr.

⁴¹ Shih faqet 29-31 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

⁴² Neni 471, i titulluar “Mënyra e procedimit nga Gjykata”, renditet në Kreun II të K. Pr. Penale, “Shqyrtimi nga Gjykata i çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve”.

Penale, ku ndër rastet për prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë nga Gjykata e Apelit parashikohet *kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me pjesëmarrjen e prokurorit në procedim*, konstatohet se me gjithë përcaktimet detyruese të këtyre dispozitave, sërish subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të bëjë një interpretim/lexim/zbatim opsional të tyre, duke iu përshtatur sipas tij, praktikës gjyqësore të gjykatës ku ai ushtron funksionet. Në këtë kontekst, megjithëse është gjendur para zbatimit të vendimit gjyqësor absolutisht të pavlefshëm sipas këtyre përcaktimeve, ai ka zgjedhur të vijojë pa reagim, në heshtje, me ekzekutimin e vendimit nr. {***}. Për rrjedhojë, pavarësisht rolit që legjislacioni penal i atribuon prokurorit në ekzekutimin e vendimeve penale, por jo vetëm, dhe ekzistencës së një morie mjetesh për të kundërshtuar pasojën që vjen nga një akt absolutisht i pavlefshëm, duket se subjekti ka zgjedhur të mos e ushtrojë atë, dhe me mosveprimin e tij, ka shprehur dakordësinë me disponimin e gjykatës.

38.4. Përpos sa më sipër, kërkesa e të dënuarit lidhej me aspektet e ekzekutimit të dënimit të përcaktuar dhe ka në thelb një marrëdhënie beneficiare me institucionin e vuajtjes së dënimit, të kushtëzuar me plotësimin e disa kriterëve të përcaktuara shprehimisht dhe në mënyrë të qartë në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, ndër to edhe zbatimi ose jo i rregullave të institucionit të vuajtjes së dënimit me burgim. Në këtë kontekst, në vendimin nr. {***}, konstatohet se, në datën 16.08.2002, të dënuarit i është dhënë masë disiplinore, megjithatë ka përfutur ulje dënimi për sjellje të mirë edhe për këtë vit.

38.5. Lidhur me ankimin ndaj vendimit nr. {***}, datë 27.11.2019, ku në lidhje me ditët e punës për efekt të uljes së dënimit të dhënë ndaj të dënuarit, subjekti paraqet si shkak ekzistencën e dy vendimmarrjeve nga gjykatat - përpos faktit se teksa gjatë shqyrtimit gjyqësor është shprehur se kërkesa e të dënuarit është e bazuar në ligj e prova dhe duhet pranuar, po në ditën e shpalljes së vendimit, ka ushtruar ankim ndaj tij, në mungesë koherence, për sa nuk ka paraqitur asnjë provë, as gjatë procesit të rivlerësimit, pavarësisht pretendimit të tij se është njohur me prova/rrethana të reja pas dhënies së vendimit. Në këtë kontekst, trupi gjykues gjithashtu vlerëson mungesë koherence në qëndrimin e subjektit, se *nuk mund të vë në dyshim dokumentacionin nga IEVP-ja*, për sa në vendimin e Gjykatës së Apelit pasqyrohet se gjatë gjykimit ka mbajtur qëndrim se *dokumentacioni për punësimin e të dënuarit ishte i paqartë, me dyshime për parregullsi dhe të dhëna të pasqyruara në to*, pretendime për të cilat gjykata shprehet se nuk ka arritur t’i argumentojë e provojë. Qëndrimi pranues ndaj çdo raporti të IEVP-ve do të nxirrte jashtë funksionit jo vetëm rolin e prokurorit në këto gjykime, por edhe të vetë gjykatës. Në vlerësimin e trupit gjykues, përveç sa më sipër, duke pohuar të tilla konsiderata, subjekti demonstroi problematika të rëndësishme lidhur me njohuritë e tij ligjore.

38.6. Gjithashtu, trupi gjykues çmon të theksojë se aktet e kohës nuk parashikojnë, madje nuk lejojnë që puna në IEVP të llogaritet si kohë dënimi. Konkretisht, ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, në nenin 34 të tij, parashikon: *...Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave*. Neni 35, paragrafi 4 i këtij ligji parashikon se: *Puna është me shpërblim dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni*. VKM-ja nr. 303, datë 25.03.2009, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, parashikon: *...Neni 83, “Punësimi”, “1. Të burgosurit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me aftësitë fizike, shëndetësore dhe psikologjike... Me urdhër të Drejtorit të IEVP-së, të burgosurit i kërkohet të marrë pjesë në parandalimin e katastrofave natyrore, epidemike, aksidenteve ose eliminimin e pasojave të tyre”*; dhe në nenin 84,

“Shpërblimi për punë”, “1. Paga për të burgosurit nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me VKM të Këshillit të Ministrave...”. Gjithashtu konstatohet që vendimmarrja e gjykatës rezulton e bazuar në Dekretin nr. 7298, datë 08.04.1989, “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, për të cilin subjekti nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim apo shqetësim lidhur me aplikimin e tij, pavarësisht se në akte të kohës evidentohet pabazueshmëria e referimit në të, si në kundërshtim me kuadrin ligjor të kohës. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur Gjykata e Lartë së fundmi: ...vijon të zbatohen ende parashikimet e Dekretit nr. 7289, datë 08.04.1989, “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor. Kjo praktikë është tërësisht e papërshtatshme për personat e paraburgosur dhe të dënuarit me heqje lirie, si dhe në shkelje të parashikimeve ligjore.⁴³

38.7. Për sa analizuar më sipër, duke gjetur të drejtë konkluzionin e Komisionit për sjellje sipërfaqësore të subjektit të rivlerësimit, që duket se kanë ndikuar në zgjidhjen e çështjes sipas kërkesave të të dënuarit, sjellja procedurale e subjektit në këto raste demonstroi mangësi në njohuritë e ligjit, si edhe mungesë përgjegjshmërie e perceptimi të rolit tejet të rëndësishëm që një prokuror luan gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, aq më tepër për raste të dënimeve të larta për individë të dënuar për vepra të rënda të Kodit Penal. Në këto kushte, ndonëse edhe kjo çështje nuk vlerësohet se e vetme mund të përbëjë një shkak për të konsideruar subjektin si të papërshtatshëm në drejtim të kriterit të aftësive profesionale, sjellja e tij në kundërshtim me vlerat që duhet të përçojë një magjistrat, për shkak të ndjeshmërisë së lartë publike, sjell si pasojë krijimin e një perceptimi publik, që cenon imazhin e organit të akuzës, prandaj trupi gjykues vlerëson të bazuar konsiderimin e saj në kuadër të efektit që ajo krijon në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

38.8. Në përfundim, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit, se çështjet e mësipërme duhen klasifikuar si një situatë e kualifikueshme sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se ato paraqiten sensitive dhe Komisioni është vënë në dijeni për to nga burime të hapura dhe mediatike, të cilat e kanë trajtuar me shqetësim situatën e prezantuar (veçanërisht rasti i dytë), me impakt të rëndësishëm publik e me pasoja domethënëse, jo vetëm për zbatimin e drejtë të ligjit në rastin konkret, por edhe për dhënien e një modeli të gabuar e të pajustificuar të trajtimit të të drejtave të të dënuarve, veçanërisht atyre të dënuar për vepra të rënda penale. Në vlerësimin e trupit gjykues, sjellja profesionale e subjektit, sipas analizës së mësipërme, do të përbente mjaftueshëm elemente për të vendosur se ai nuk mund të vijonte më me ushtrimin e funksioneve të prokurorit dhe të ngarkohej me përgjegjësi disiplinore sipas kësaj dispozite.

39. Përfundimisht, mbështetur në konkluzionet e mësipërme dhe në parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mustafa Turku ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 708, datë 26.10.2023, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, gjendet i bazuar në prova dhe në ligj.

⁴³ Shih vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 66, datë 13.01.2023.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 708, datë 26.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Mustafa Turku.
 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
- U shpall sot, më datë 29.04.2025, në Tiranë.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi